



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 29

2003

Maj

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9034 datë 20.3.2003	Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi..	921
Ligj nr.9035 datë 27.3.2003	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për ripranimin e personave”.....	926
Ligj nr.9036 datë 27.3.2003	Për ratifikimin e “Konventës ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Moldavisë për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe për parandalimin e evazionit fiskal për tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin”.....	935
Ligj nr.9037 datë 27.3.2003	Për ratifikimin e “Protokollit të katërt shtesë të Marrëveshjes për Forcat Paqeruajtëse Shumëkombëshe të Europës Juglindore”.....	950
Ligj nr.9038 datë 27.3.2003	Pë ratifikimin e “Marrëveshjes ndermejt Qeverisë së Republikës së Shqipërisë Qeverisë së Republikë së Kroacisë për ripranimin e personave me qëndrim të paligjshëm.....	955

L I G J
Nr.9034, datë 20.3.2003

PËR EMIGRIMIN E SHTETASVE SHQIPTARË
PËR MOTIVE PUNËSIMI

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

1. Ky ligj rregullon marrëdhëniet në fushën e emigracionit të shtetasve shqiptarë, që largohen nga Republika e Shqipërisë për motive punësimi.

2. Shteti garanton përkujdesjen dhe mbrojtjen e shtetasve të tij emigrantë, si dhe ruajtjen dhe forcimin e lidhjeve të tyre me Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllime të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë kuptimin si vijon:

1. “Emigrant” konsiderohen shtetasit shqiptarë që largohen nga Republika e Shqipërisë në vende të tjera për qëllime punësimi, në pajtim me legjislacionin vendas dhe të shtetit pritës.

2. “Shtet pritës” konsiderohet vendi ku shtetasit shqiptarë emigrojnë për qëllime punësimi.

3. “Emigrant afatgjatë” konsiderohet emigranti, i cili qëndron jashtë shtetit për një periudhë kohore më të gjatë se një vit.

4. “Emigrant afatshkurtër” konsiderohet emigranti, i cili qëndron jashtë shtetit për një periudhë kohore më të shkurtër se një vit.

5. “Punonjës/e emigrant/e” konsiderohen personat punëdhënës, punëmarrës dhe të vetëpunësuar, që punësohen në një shtet tjetër, pa qenë shtetas/e të tij.

6. “Pjesëtar familjeje” konsiderohen paraardhësit ose pasardhësit e shkallës së parë, si dhe personat e tjerë në ngarkim, në bazë të legjislacionit shqiptar.

7. “Emigrantë të parregullt” konsiderohen shtetasit shqiptarë emigrantë, të cilët nuk përmbushin të gjitha kushtet dhe kërkesat e vendosura nga shteti pritës, lidhur me hyrjen, qëndrimin dhe ushtrimin e një veprimtarie në territorin e këtij shteti.

8. “Agjenci private punësimi” konsiderohen personat fizikë ose juridikë, të cilët ofrojnë shërbime punësimi, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Subjektet

Subjekte të këtij ligji janë shtetasit shqiptarë, të cilët emigrojnë për qëllime punësimi në një shtet tjetër, sipas dispozitave të këtij ligji dhe të standardeve ndërkombëtare të pranuara edhe nga shteti pritës.

KREU II
TË DREJTAT E SHTETASVE SHQIPTARË
PËR EMIGRIM

Neni 4

E drejta për të emigruar

1. Çdo person ka të drejtë të largohet nga territori i Republikës së Shqipërisë.
2. E drejta për t'u larguar nga territori i Republikës së Shqipërisë nuk kufizohet, me përjashtim kur bëhet për të mbrojtur sigurimin kombëtar, rendin publik, shëndetin publik, moralin, të drejtat dhe liritë e të tjerëve, sipas kushteve të parashikuara në ligj dhe në përputhje me parimet e përgjithshme të akteve ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë.
3. E drejta për t'u larguar kufizohet me vendim gjykate.
4. Çdo shtetas shqiptar, i cili largohet nga territori i Republikës së Shqipërisë, ka të drejtë të rikthehet. Mundësia e pajisjes me leje kalimi i jepet çdo shtetasi shqiptar, që është jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nga përfaqësitë diplomatike.

Neni 5

Liritë dhe të drejtat politike

1. Shtetasit shqiptarë emigrantë gëzojnë liritë dhe të drejtat politike, të parashikuara nga Kushtetuta dhe legjislacioni shqiptar në fuqi, duke marrë pjesë aktive në jetën politike të vendit.
2. Shteti krijon lehtësi për emigrantët që kthehen në atdhe për të ushtruar të drejtën e votës në zbatim të Kodit Zgjedhor.

Neni 6

Përfaqësimi i interesave

Shteti shqiptar siguron dhe mbështet kontaktin e emigrantëve shqiptarë, nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur të organizatave të tyre, me organet e qeverisjes qendrore dhe vendore për të paraqitur dhe mbrojtur interesat e tyre.

Neni 7

E drejta për shërbime

Punonjësit emigrantë kanë të drejtën e informimit dhe të këshillimit falas në fushën e formimit profesional, të shërbimeve të ndërmjetësimit për punësim, të mbrojtjes sociale, të organizimit në sindikata, si dhe të njohjes së kushteve të jetesës dhe mundësive për strehim, arsimim dhe sigurime shoqërore.

KREU III
DETYRIMET E SHTETIT SHQIPTAR
PËR EMIGRANTËT

Neni 8

Garantimi i lëvizjes së lirë

1. Shteti shqiptar garanton lëvizjen e lirë të shtetasve për qëllime punësimi, lidh marrëveshje punësimi me shtetet pritëse, ndihmon dhe lehtëson integrimin e emigrantëve në vendet pritëse, në zbatim të të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga konventat ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë.
2. Shtetasit shqiptarë që dëshirojnë të emigrojnë jashtë Shqipërisë për qëllime punësimi, regjistrohen në një regjistër të veçantë "Për emigrantët", i cili mbahet nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale.

Neni 9

Informacioni i rremë

1. Shteti shqiptar ndalon çdo lloj informacioni të rremë të dhënë nga persona fizikë ose juridikë dhe veprimtari të kundërligjshme për qëllime përfitimi në fushën e emigrimit të shtetasve shqiptarë për motive punësimi.

2. Ushtrimi i veprimtarive të mësipërme dënohet sipas dispozitave të Kodit Penal.

Neni 10

Shërbimi konsullor

1. Shteti shqiptar, nëpërmjet shërbimit konsullor në shtetet pritëse, ndihmon dhe lehtëson zgjidhjen e problemeve të shtetasve shqiptarë emigrantë.

2. Tarifat për shërbimet konsullore ndaj emigrantëve përcaktohen me ligj të veçantë.

3. Në shtetet pritëse, ku nuk ka përfaqësi diplomatike të Republikës së Shqipërisë, këtë veprimtari e kryejnë përfaqësitë diplomatike të akredituara në shtete të tjera, si dhe konsujt e nderit të emëruar në bazë të ligjit nr. 8372, datë 9.7.1998 “Për ushtrimin e funksioneve konsullore nga përfaqësitë diplomatike ose konsullore”.

4. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme hartojnë dhe zbatojnë programe për kualifikimin e personelit të shërbimit konsullor në fushën e emigrimit.

Neni 11

Ruajtja e lidhjeve ndërkomunitare

1. Shteti mbështet dhe ndihmon ngritjen, forcimin dhe zhvillimin e komuniteteve shqiptare jashtë vendit, bashkëpunon me to, duke konsoliduar veprimtaritë e ndërmarra nga klube, bashkime, shoqata dhe familje shqiptare me synim forcimin e lidhjeve midis tyre dhe me atdheun.

2. Shteti, duke respektuar legjislacionin e shtetit pritës, si dhe marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, kujdeset për arsimimin e emigrantëve dhe të familjeve të tyre në gjuhën shqipe, krijon kushte për ruajtjen e gjuhës, kulturës dhe trashëgimisë kombëtare, si dhe të lidhjeve shpirtërore në mes komuniteteve të emigrantëve.

Neni 12

Shteti shqiptar kujdeset edhe për ata shtetas dhe familjet e tyre, të cilët jetojnë e punojnë në shtetet pritëse, por që nuk kanë përfituar ende statusin e emigrantit.

Neni 13

Shteti nxit kthimin e vullnetshëm të emigrantëve në atdhe dhe riintegrimin e tyre në jetën ekonomike, sociale të vendit, nëpërmjet krijimit të lehtësive ligjore, financiare dhe fiskale dhe të zbatimit të programeve të zhvillimit të biznesit, të punësimit dhe të formimit profesional. Masat dhe strukturat përkatëse përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 14

Shteti krijon lehtësi dhe kushte favorizuese për dërgesat monetare të emigrantëve në bankat shqiptare.

Neni 15

1. Sigurimet shoqërore për emigrantët shqiptarë afatgjatë dhe afatshkurtër rregullohen në bazë të legjislacionit për sigurimet shoqërore të shtetit shqiptar dhe shtetit pritës, marrëveshjeve dypalëshe në këtë fushë dhe konventave ndërkombëtare për sigurimet shoqërore ku Republika e Shqipërisë është

palë.

2. Shteti shqiptar, nëpërmjet strukturave përkatëse, nxit hapjen e agjencive për derdhjen e kontributeve të sigurimit vullnetar të emigrantëve në vendet pritëse.

KREU IV STRUKTURAT SHTETËRORE DHE PRIVATE TË EMIGRACIONIT

Neni 16

Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale është autoriteti kompetent kombëtar, që përgatit politikat dhe propozon ndryshime në legjislacionin e fushës emigratore, duke ia paraqitur për miratim Këshillit të Ministrave.

Neni 17

Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale

Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, nëpërmjet strukturave vartëse të saj, në bashkëpunim me ministritë dhe organizatat jofitimprurëse, ushtron kompetencat e saj për:

- a) përkujdesjen ndaj emigrantëve shqiptarë para largimit nga vendi, gjatë qëndrimit në vendin pritës dhe gjatë rikthimit të tyre në Republikën e Shqipërisë;
- b) planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e politikave të emigrimit;
- c) realizimin e marrëveshjeve me vende të tjera për lehtësimin e emigrimit legal të shtetasve shqiptarë, lehtësimin e qëndrimit të tyre në vendet pritëse dhe garantimin e të drejtave të tyre, sipas legjislacionit të vendeve pritëse, në përputhje me konventat ndërkombëtare për të drejtat e emigrantëve;
- ç) studimin dhe propozimin e politikave të veçanta ekonomike e sociale, që stimulojnë emigrantët, për të investuar kursimet e tyre në Shqipëri, me qëllim riintegrimin e tyre;
- d) përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e emigrimit.

Neni 18

Agjencitë private të punësimit

Shteti njeh dhe përkrah veprimtaritë e agjencive private të punësimit që konsistojnë në:

- a) shërbime që lidhen me ndërmjetësimin midis punëkërkesve dhe punëdhënësve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, pa qenë palë e marrëdhënieve të punësimit, që mund të lindin nga ky ndërmjetësim;
- b) shërbime për informimin lidhur me trajnimin e punëkërkesve, për t'i bërë ata të disponueshëm për subjekte fizike ose juridike;
- c) dhënien e informacionit dhe ndërmjetësimin për menaxhimin e punësimit të shtetasve shqiptarë, brenda dhe jashtë vendit.

KREU V DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 19

Shtetasit shqiptarë, që kanë emigruar para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, regjistrohen në regjistrin “Për emigrantët” në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale.

Neni 20

Ngarkohet Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 21

Ligji nr.7939, datë 25.5.1995 “Për migracionin”, si dhe çdo dispozitë tjetër ligjore që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 22

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3779, datë 16.4.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

L I G J

Nr.9035, datë 27.3.2003

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE”

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për ripranimin e personave”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3786, datë 22.4.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

MARRËVESHJE

NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË MBI RIPRANIMIN E PERSONAVE (MARRËVESHJA E RIPRANIMIT)

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë:
duke u nisur nga marrëdhëniet miqësore ndërmjet të dy shteteve dhe popujve të tyre;
me qëllim që të dalin përpara migrimit ilegal në frymën e përpjekjeve europiane;
duke synuar që të lehtësojnë ripranimin e personave, të cilët qëndrojnë ilegalisht në territorin

sovrani të secilës Palë tjetër Kontraktuese, si dhe transportimin transit të detyruar në përputhje me normat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare dhe në frymën e bashkëpunimit, u morën vesh si vijon:

PJESA E PARË PRANIMI I SHTETASVE TË VET

Neni 1

1. Secila Palë Kontraktuese, me kërkesë të Palës tjetër Kontraktuese, pranon pa formalitete të posaçme atë person, i cili në territorin sovran të Palës Kontraktuese, që paraqet kërkesën, nuk plotëson ose nuk plotëson më kushtet në fuqi për hyrje ose qëndrim, kur vërtetohet ose shpjegohet në mënyrë bindëse se ai ka shtetësinë e Palës Kontraktuese, së cilës i drejtohet kërkesa. Vërtetimi i identitetit të personit është i domosdoshëm vetëm atëherë kur shtetësia nuk del qartë pa një vërtetim të tillë.

2. Paragrafi 1 zbatohet në mënyrë analoge edhe për fëmijët e lindur jashtë vendit dhe bashkëshortin/bashkëshorten me shtetësi tjetër të personit që do të pranohet, të cilët nuk kanë të drejtën e qëndrimit në territorin e Palës Kontraktuese, që paraqet kërkesën, dhe kanë ose marrin të drejtën e hyrjes dhe të qëndrimit në territorin e Palës Kontraktuese, së cilës i drejtohet kërkesa.

Neni 2

1. Shtetësia mund të vërtetohet nëpërmjet:

- 1) dokumenteve të shtetësisë, për të cilat nuk ka dyshim se i përkasin një personi;
- 2) pasaportave të çdo lloji (pasaporta kombëtare, pasaporta kolektive, pasaporta diplomatike, pasaporta shërbimi, dokumente që e zëvendësojnë pasaportën);
- 3) matrikullave të marinarëve (librezave detare);
- 4) letërnjoftimeve (duke përfshirë edhe letërnjoftimet e përkohshme dhe zëvendësuese);
- 5) dokumenteve ushtarake të identifikimit dhe letërnjoftimeve ushtarake;
- 6) letërnjoftimeve të fëmijëve si dokumente që zëvendësojnë pasaportën;
- 7) dokumenteve të lëshuara zyrtarisht, nga të cilat del shtetësia.

Në këto raste, personi në fjalë ripranohet pa formalitete të posaçme.

2. Shtetësia mund të shpjegohet në mënyrë bindëse nëpërmjet:

- 1) një kopjeje të dokumenteve të përmendura në paragrafin 1;
- 2) lejeve për drejtim automjeti (patentave);
- 3) dokumenteve të lindjes;
- 4) kopjeve të dokumenteve të lartpërmendura;
- 5) deponimeve të dëshmitarëve;
- 6) deponimeve të personit në fjalë;
- 7) rezultatit të dëgjimit të personit në fjalë në përfaqësinë kompetente diplomatike të Palës Kontraktuese, së cilës i drejtohet kërkesa;
- 8) dokumenteve të tjera, të cilat mund të shërbejnë për përcaktimin e shtetësisë.

Në këto raste, ripranimi i personit në fjalë bëhet sipas dispozitave të nenit 3.

3. Dokumentet e përmendura në paragrafët 1 dhe 2 mjaftojnë për të vërtetuar ose për të shpjeguar në mënyrë bindëse shtetësinë edhe atëherë kur kanë dalë nga fuqia për shkak të mbarimit të afatit të vlefshmërisë.

Neni 3

1. Në rast se mungojnë dokumentet identifikuese, ripranimi kryhet në bazë të një kërkesë ripranimi. Kërkesa e ripranimit duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme, në përputhje me dokumentet ekzistuese, respektivisht me deponimet e personit që kërkohet të pranohet:

- 1) të dhënat personale të personave që kërkohen të ripranohen (emri, mbiemri, datëlindja dhe, përderisa kjo të jetë e mundur, vendlindja, si dhe vendbanimi i fundit në territorin sovran të Palës Kontraktuese, së cilës i drejtohet kërkesa);
- 2) emërtimin e mjeteve që shpjegojnë në mënyrë bindëse shtetësinë e personave në fjalë;

3) shënimin që personi në fjalë, për shkak të moshës ose sëmundjes, eventualisht ka nevojë për ndihmë, përkujdesje ose vëmendje të veçantë (me miratimin e personit që ripranohet);

4) masa të tjera mbrojtëse ose sigurie të nevojshme në rast të veçantë gjatë dorëzimit të personit.

2. Pala Kontraktuese, së cilës iu paraqit kërkesa, i përgjigjet kërkesës së ripranimit menjëherë, por jo më vonë se brenda një muaji. Afati fillon në atë moment kur autoriteti kompetent i Palës, së cilës i drejtohet kërkesa, e merr kërkesën. Pas mbarimit të këtij afati, miratimi i ripranimit konsiderohet si i dhënë. Përderisa kjo të jetë e nevojshme, Pala Kontraktuese, së cilës iu drejtua kërkesa, lëshon menjëherë dokumentet e udhëtimit që janë të domosdoshme për rikthimin e personit që do të ripranohet, me afat vlefshmërie prej gjashtë muajsh.

3) Në rast se, për shkak të ndonjë pengese juridike ose faktike, nuk mund të realizohet dorëzimi i personit në fjalë brenda afatit të vlefshmërisë së dokumentit të lëshuar të udhëtimit, atëherë përfaqësia kompetente diplomatike e Palës Kontraktuese, së cilës iu drejtua kërkesa, lëshon brenda 14 ditëve një dokument të ri udhëtimi me një afat shtesë gjashtëmuajore.

4. Autoriteti kompetent i Palës Kontraktuese, i cili paraqet kërkesën, do ta njoftojë menjëherë, jo më vonë se shtatë ditë para rikthimit të parashikuar, autoritetin kompetent të Palës Kontraktuese, së cilës iu drejtua kërkesa, për rikthimin e personit në fjalë.

Neni 4

Pala Kontraktuese, e cila paraqet kërkesën, e merr prapa pa formalitete të posaçme një person të ripranuar nga Pala Kontraktuese, së cilës iu drejtua kërkesa, kur brenda tre muajsh pas ripranimit të personit vërtetohet se nuk u plotësuan kushtet paraprake të përmendura në nenin 1 për ripranim nga Pala Kontraktuese, së cilës iu drejtua kërkesa.

PJESA E DYTË

PRANIMI I SHTETASVE TË NJË SHTETI TË TRETË NË RASTIN E HYRJES SË PALIGJSHME DHE QËNDRIMIT TË PALIGJSHËM

Neni 5

1. Secila Palë Kontraktuese pranon me kërkesë të Palës tjetër Kontraktuese atë person që nuk ka as shtetësinë gjermane, as shtetësinë shqiptare, kur ai nuk plotëson ose nuk plotëson më kushtet në fuqi për hyrje ose qëndrim dhe kur vërtetohet ose shpjegohet në mënyrë të bindëse se ai:

- posedon një vizë të vlefshme, të lëshuar nga Pala tjetër Kontraktuese ose një lejeqëndrim të vlefshëm, të lëshuar nga Pala tjetër Kontraktuese;

- ka hyrë drejtpërdrejt dhe në mënyrë të paligjshme në rrugë ajrore ose detare nga territori i Palës Kontraktuese, së cilës iu drejtua kërkesa, në territorin e Palës Kontraktuese, e cila ka paraqitur kërkesën;

- ka hyrë në mënyrë ilegale duke përdorur dokumente të falsifikuara të Palës tjetër Kontraktuese.

2. Detyrimi i Palës Kontraktuese së cilës iu drejtua kërkesa, për ripranimin e personit ekziston edhe atëherë kur të dy Palët Kontraktuese kanë lëshuar një vizë ose një lejeqëndrim ndërkohë të skaduar, duke pasur afat më të gjatë vlefshmërie viza ose leja e qëndrimit e lëshuar nga Pala Kontraktuese, së cilës iu drejtua kërkesa.

Neni 6

1. Hyrja e drejtpërdrejtë dhe qëndrimi i shtetasve të një shteti të tretë në territorin e Palës Kontraktuese, e cila paraqet kërkesën, kundërligjshmëria e kësaj hyrjeje dhe këtij qëndrimi, si dhe posedimi i një vize ose i një lejeqëndrimi tjetër të vlefshëm të lëshuar nga Pala Kontraktuese, së cilës iu drejtua kërkesa, për territorin e saj duhen të vërtetohen ose të shpjegohen në mënyrë bindëse.

2. Hyrja dhe qëndrimi në territorin e Palës Kontraktuese, e cila paraqet kërkesën, si dhe posedimi i një vize të vlefshme ose i një lejeqëndrimi tjetër të vlefshëm të lëshuar nga Pala Kontraktuese, së cilës iu drejtua kërkesa:

- a) vërtetohen nëpërmjet:
 - vulës së daljes dhe të hyrjes së autoriteteve të Palës Kontraktuese, së cilës iu drejtua kërkesa, në dokumentet e udhëtimit;
 - shënimeve të autoriteteve të Palës Kontraktuese, së cilës iu drejtua kërkesa, në dokumentet e udhëtimit;
 - biletave të avionit, vërtetimeve ose faturave, të cilat mund të japin provë të pagabueshme për qëndrimin e personit në territorin e Palës Kontraktuese, së cilës iu drejtua kërkesa.
- Prova e paraqitur në këtë mënyrë njihet si e vlefshme ndërmjet Palëve Kontraktuese, pa bërë shqyrtime të mëtejshme.
- b) shpjegohen në mënyrë bindëse nëpërmjet:
 - biletave të trenit, autobusit, avionëve ose anijeve, të cilat dëshmojnë itinerarin e personit në territorin e Palës Kontraktuese së cilës iu drejtua kërkesa;
 - vendit dhe rrethanave, në të cilat u kap i huaji pas hyrjes së tij;
 - deponimeve të punonjësve të autoriteteve kufitare, të cilat mund të konfirmojnë kalimin e kufirit;
 - deponimeve të dëshmitarëve.

Një shpjegim bindës i bërë në këtë mënyrë konsiderohet nga Palët Kontraktuese si i prerë, përderisa Pala Kontraktuese, së cilës iu drejtua kërkesa, nuk ka dhënë deklaratë të kundërt.

3. Kundërligjshmëria e hyrjes ose e qëndrimit vërtetohet nëpërmjet dokumenteve të kalimit të kufirit të personit, në të cilat mungon viza e nevojshme ose lejeqëndrimi për territorin e Palës Kontraktuese, e cila paraqet kërkesën. Për të shpjeguar në mënyrë bindëse kundërligjshmërinë e hyrjes ose të qëndrimit mjafton deklaratat e Palës Kontraktuese, e cila paraqet kërkesën, se sipas konstatimeve të saj personi në fjalë nuk posedon dokumentet e nevojshme për kalimin e kufirit ose vizën e nevojshme ose një lejeqëndrim tjetër.

Neni 7

1. Në rastin e ripranimit të një personi sipas nenit 5, kërkesa për ripranim duhet të bëhet brenda dymbëdhjetë muajve pas marrjes dijeni të autoriteteve kompetente për hyrjen ose qëndrimin e kundërligjshëm të personit në fjalë. Në rast se personi ka hyrë në territorin e Palës Kontraktuese, e cila paraqet kërkesën, para hyrjes në fuqi të marrëveshjes, atëherë afati fillon me hyrjen në fuqi të marrëveshjes. Pala Kontraktuese, së cilës iu drejtua kërkesa, i përgjigjet menjëherë, por jo më vonë se brenda 1 muaji, kërkesës për ripranim. Pala Kontraktuese, së cilës iu drejtua kërkesa, lëshon- përderisa kjo të jetë e nevojshme – menjëherë dokumentet e udhëtimit të nevojshme për rikthimin e personit që do të ripranohet, me afat vlefshmërie prej gjashtë muajsh.

2. Dorëzimi i personit në fjalë bëhet menjëherë, por jo më vonë se brenda një afati prej tre muajsh pas miratimit të ripranimit nga Pala Kontraktuese, së cilës iu drejtua kërkesa. Në rast pengesash juridike ose faktike për dorëzimin, ky afat do të zgjatet me kërkesë të Palës Kontraktuese, që paraqet kërkesën. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese merren vesh me shkrim për kohën e parashikuar të ripranimit.

Neni 8

Në rastin e ripranimit të një personi sipas nenit 5, Pala Kontraktuese, e cila paraqet kërkesën, e merr mbrapsht personin në fjalë pa formalitet të veçantë, kur Pala Kontraktuese, së cilës iu drejtua kërkesa, konstaton brenda tridhjetë ditësh pas ripranimit se nuk janë plotësuar kushtet për ripranim.

PJESA E TRETË

Neni 9

Rikthimet sipas neneve 3 dhe 5 kryhen si rregull në rrugë ajrore. Personat që do të rikthehen do të shoqërohen nga personel i specializuar sigurie, në ato raste kur këtë e bën të nevojshme siguria e qarkullimit ajror.

PJESA E KATËRT
TRANSPORTIMI TRANSIT I DETYRUAR

Neni 10

1. Palët Kontraktuese e lejojnë transportimin transit të detyruar të shtetasve të një shteti të tretë nëpër territorin e vet, kur Pala tjetër Kontraktuese bën kërkesë përkatëse dhe kur është i garantuar vazhdimi i udhëtimit në shtete të mundshme transiti dhe në shtetin e destinacionit.

2. Transportimi transit i detyruar mund të refuzohet kur:

1) personi në fjalë do të rrezikohet nga përndjekja në një shtet tjetër transit ose në shtetin e destinacionit, për shkak të arsyeve që përmenden në konventat, sipas nenit 15 paragrafi 1 të kësaj Marrëveshjeje ose kur personin do ta priste ndjekja penale, ose zbatimi i dënimit penal;

2) personi në fjalë kërcënohet nga ndjekja penale në territorin e Palës Kontraktuese, së cilës iu drejtua kërkesa; në atë rast Pala Kontraktuese, e cila paraqet kërkesën, duhet të njoftohet përkatësisht para transportit transit të detyruar.

3. Pavarësisht nga miratimi i dhënë, personat që u morën përsipër për transportim transit të detyruar mund t'i kthehen Palës tjetër Kontraktuese, kur më vonë dalin ose bëhen të njohura fakte në kuptimin e nenit 2, që bien në kundërshtim me transportimin transit të detyruar ose kur vazhdimi i rrugës ose pranimit nga shteti i destinacionit nuk garantohet më.

PJESA E PESTË
MBROJTJA E TË DHËNAVE

Neni 11

1. Përderisa për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje duhen komunikuar të dhëna personale, këto informacione duhet t'u referohen vetëm:

1) të dhënave personale të personit që dorëzohet dhe, nëse e kërkon rasti, të anëtarëve të familjes së tij (mbiemri, emri, në rastin e duhur mbiemri i mëparshëm, emrat shtesë ose pseudonime, datëlindja, vendlindja, seksi, shtetësia aktuale dhe e mëparshme);

2) letërnjoftimit ose pasaportës së udhëtimit (numri serial, afati i vlefshmërisë, data e lëshimit, autoriteti lëshues, vendi i lëshimit etj.);

3) të dhënave të tjera të nevojshme për identifikimin e personit që dorëzohet;

4) vendeve të qëndrimit dhe itinerareve;

5) të dhënave të tjera me kërkesë të një Pale Kontraktuese, të cilat i nevojiten asaj për shqyrtimin e kushteve të ripranimit sipas kësaj Marrëveshjeje.

2. Përderisa mbi bazën e kësaj Marrëveshjeje komunikohen të dhëna personale, janë të vlefshme rregullat e mëposhtme, duke respektuar dispozitat brendashtetërore ligjore që vlejnë për secilën Palë Kontraktuese:

1) Përdorimi i të dhënave nga marrësi lejohet vetëm për qëllimin e shënuar dhe vetëm me kushtet e caktuara nga autoriteti komunikues.

2) Marrësi e informon autoritetin komunikues, me kërkesën e këtij të fundit, për përdorimin e të dhënave të komunikuar dhe për rezultatet e arritura përmes tij.

3) Të dhëna personale mund t'u komunikohen vetëm autoriteteve kompetente. Komunikimi i tyre për në institucione të tjera mund të bëhet vetëm me miratimin paraprak të autoritetit komunikues.

4) Autoriteti komunikues mban përgjegjësi për korrektësinë e të dhënave të komunikuar, si dhe është i detyruar të respektojë domosdoshmërinë dhe përshtatshmërinë lidhur me qëllimin e komunikimit, duke mbajtur parasysh dispozitat ndaluese të komunikimit të të dhënave sipas legjislacionit brendashtetëror të secilit vend. Nëse vërtetohet se janë komunikuar të dhëna të gabuara ose të dhëna që nuk duheshin komunikuar, atëherë një gjë e tillë i duhet njoftuar menjëherë marrësit. Ai është i detyruar të bëjë korrigjimin ose asgjësimin e të dhënave në fjalë.

5) Autoriteti komunikues dhe autoriteti marrës janë të detyruar të dokumentojnë në dosjet e tyre komunikimin dhe marrjen e të dhënave personale.

6) Autoriteti komunikues dhe autoriteti marrës janë të detyruar të mbrojnë të dhënat personale

në mënyrë të efektshme kundër hapjes së paautorizuar, ndryshimit të paautorizuar dhe bërjes së tyre publike në mënyrë të paautorizuar.

PJESA E GJASHTË SHPENZIMET DHE AUTORITETET KOMPETENTE

Neni 12

Të gjitha shpenzimet që lidhen me rikthimin e personit deri në kufirin e Palës Kontraktuese, së cilës iu drejtua kërkesa, si edhe shpenzimet për transportimin transit të detyruar sipas nenit 10 merren përsipër nga Pala Kontraktuese, e cila paraqet kërkesën.

Në rastin e ripranimit sipas neneve 4, 8 dhe 10 paragrafi 3, Pala Kontraktuese, e cila paraqet kërkesën, përballon gjithashtu shpenzimet e nevojshme për udhëtimin kthim.

Neni 13

1. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese janë:

1) Për paraqitjen e kërkesave për ripranim dhe për shqyrtimin e tyre sipas neneve 3, 4, 5 dhe 8,

- për Republikën e Shqipërisë

Ministria e Rendit Publik

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Sheshi Skënderbej nr.3

Tiranë/Shqipëri

Tel.: 00355 4 364953

Fax.: 00355 4 256852

- për Republikën Federale të Gjermanisë

autoritetet e landeve federale të ngarkuara me zbatimin e së drejtës të të huajve (zyrat për të huajt, Registrarsprachen = drejtoritë e administratës rajonale në disa lande federale, ministrat/senatorët së Punëve të Brendshme të landeve) ose

Bundesgrenzschutzdirektion (Drejtoria e Mbrojtjes Kufitare Federale)

Roonstrasse 13

D-56068 Koblenz

Telefon: 0049 261 399 – 0 (centrali = Vermittlung)

0049 261 399 – 0 (qendra operative / shërbimi 24 orësh)

Faks: 0049 261 399218

2) Për pranimin e kërkesave për ripranim:

- për Republikën e Shqipërisë

Ministria e Rendit Publik

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Sheshi Skënderbej nr.3

Tiranë/Shqipëri

Tel.: 00355 4 364953

Fax.: 00355 4 256852

Një kopje e kërkesës për ripranim do t'i dërgohet përfaqësisë kompetente diplomatike të Republikës së Shqipërisë në Republikën Federale të Gjermanisë.

- për Republikën Federale të Gjermanisë

- përfaqësia kompetente diplomatike e Republikës Federale të Gjermanisë në Republikën e Shqipërisë.

3) për paraqitjen e kërkesës për dokumentet e udhëtimit:

-për Republikën e Shqipërisë

Ministria e Rendit Publik

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Sheshi Skënderbej nr.3

Tiranë/Shqipëri

Tel.:00355 4 364953

Fax.:00355 4 256852
- për Republikën Federale të Gjermanisë
- autoritetet e landeve federale të ngarkuara me zbatimin e të drejtës të të huajve (zyrat për të huajt, Regierungspräsidien = drejtoritë e administratës rajonale në disa lande federale, ministër/senatorët e Punëve të Brendshme të landeve) ose
Bundesgrenzschutzdirektion (Drejtoria e Mbrojtjes Kufitare Federale)
Roonstrasse 13
D-56068 Koblenz
Telefon: 0049 261 399-0 (centrali =Vermittlung)
0049 261 399-0 (qendra operative / shërbimi 24 orësh)
Faks: 0049 261 399218
4) Për paraqitjen e kërkesave për transportim transit të detyruar dhe për shqyrtimin e tyre, sipas nenit 10 të kësaj Marrëveshjeje:
- për Republikën e Shqipërisë
Ministria e Rendit Publik
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
Sheshi Skënderbej nr.3
Tiranë/Shqipëri
Tel.:00355 4 364953
Fax.:00355 4 256852
- për Republikën Federale të Gjermanisë
Bundesgrenzschutzdirektion (Drejtoria e Mbrojtjes Kufitare Federale)
Roonstrasse 13
D-56068 Koblenz
Telefon: 0049 261 399 – 0 (Centrali = Vermittlung)
0049 261 399 – 0 (qendra operative /shërbimi 24 orësh)
Faks: 0049 261 399218
5. Për llogaritjen e shpenzimeve sipas nenit 12 të kësaj Marrëveshjeje:
- për Republikën e Shqipërisë
Ministria e Rendit Publik
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
Sheshi Skënderbej nr.3
Tiranë/Shqipëri
Tel.: 00355 4 364953
Fax.: 00355 4 256852
- për Republikën Federale të Gjermanisë
Bundesgrenzschutzdirektion (Drejtoria e Mbrojtjes Kufitare Federale)
Roonstrasse 13
D-56068 Koblenz
Telefon: 0049 261 399 – 0 (centrali = Vermittlung)
0049 261 399 – 0 (qendra operative/shërbimi 24 orësh)
Faks:0049 261 399218
2. Palët Kontraktuese e informojnë njëra-tjetrën me kohë për ndryshime eventuale lidhur me kompetencat në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje.

PJESA E SHTATË DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 14

1. Specialistët e të dy Palëve Kontraktuese do të merren vesh për hollësitë e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.
2. Palët Kontraktuese marrin përsipër që problemet që lindin gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, t'i zgjidhin në frymën e mirëkuptimit. Secila Palë Kontraktuese, kur del nevoja, mund të ftojë Palën tjetër Kontraktuese për të zhvilluar bisedime për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 15

1. Zbatimi i Marrëveshjes së Gjenevës e datës 28 qershor 1951 “Mbi pozitën juridike të refugjatëve”, së bashku me protokollin e Nju Jorkut të datës 31 janar 1967 “Mbi pozitën juridike të refugjatëve”, mbetet i paprekur.

2. Detyrimet e Palëve Kontraktuese që rrjedhin nga marrëveshjet e tjera mbi bazën e të drejtës ndërkombëtare mbeten të paprekura.

Neni 16

1. Kjo Marrëveshje lidhet për një afat të papërcaktuar.

2. Marrëveshja, me përjashtim të dispozitave të pjesës së dytë, nenet 5 deri 8, (Pranimi i shtetasve të një shteti të tretë në rastin e hyrjes së paligjshme dhe qëndrimit të paligjshëm) hyn në fuqi ditën e parë të muajit të dytë pas ditës, në të cilën Qeveria e Republikës së Shqipërisë e ka njoftuar me notë Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë se janë të plotësuar kushtet paraprake brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi.

3. Dispozitat e pjesës së dytë, nenet 5 deri 8, (Pranimi i shtetasve të një shteti të tretë në rastin e hyrjes së paligjshme dhe qëndrimit të paligjshëm) hyjnë në fuqi ditën e parë të muajit të dytë pas ditës, në të cilën Qeveria e Republikës së Shqipërisë e ka njoftuar Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë se janë plotësuar procedurat e brendshme paraprake për hyrjen në fuqi të këtyre dispozitave. Megjithatë, dispozita në pjesën e dytë, neni 5, paragrafi 1, alinea e tretë hyn në fuqi jo më vonë se pas 5 vjetësh pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, ndërsa dispozitat e tjera të pjesës së dytë hyjnë në fuqi jo më vonë se pas dy vjetësh pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 17

Porosia për regjistrimin e kësaj Marrëveshjeje tek Sekretariati i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, sipas nenit 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, jepet menjëherë pas hyrjes së saj në fuqi nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë. Pala tjetër Kontraktuese do të njoftohet përkatësisht duke iu shënuar numri i regjistrimit i OKB-së, sapo ky të jetë konfirmuar nga Sekretariati i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Neni 18

1. Secila Palë Kontraktuese, kur ka një arsye të fortë, mund të pezullojë ose të shfuqizojë këtë Marrëveshje në rrugë diplomatike.

2. Pezullimi ose shfuqizimi bëhet i efektshëm ditën e parë të muajit, që vjen pas atij muaji, në të cilin Pala tjetër Kontraktuese e ka marrë notën.

Bërë në Berlin, më datë 18 nëntor 2002 në dy origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur secili tekst vlerë të barabartë.

L I G J

Nr.9036, datë 27.3.2003

PËR RATIFIKIMIN E “KONVENTËS NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË MOLDAVISË PËR SHMANGIEN E TAKSIMIT TË DYFISHTË DHE PËR PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL PËR TATIMET MBI TË ARDHURAT DHE MBI KAPITALIN”

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Konventa ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Moldavisë për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe për parandalimin e evazionit fiskal për tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3787, datë 22.4.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

KONVENTË

NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MOLDAVISË
PËR SHMANGIEN E TAKSIMIT TË DYFISHTË DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT
FISKAL, LIDHUR ME TATIMET MBI TË ARDHURAT DHE MBI KAPITALIN

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Moldavisë:
duke dëshiruar të përfundojnë një Konventë për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe
parandalimin e evazionit fiskal, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin,
kanë rënë dakord për sa vijon:

Neni 1

Personat që mbulon Konventa

Kjo Konventë do të zbatohet ndaj personave që janë rezidentë të njërit ose të të dy Shteteve Kontraktuese.

Neni 2

Tatimet që mbulon Konventa

1. Kjo Konventë do të zbatohet për tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin të vendosura në emër të një Shteti Kontraktues ose nga njësitë e tij administrativo-territoriale apo autoritetet lokale, pavarësisht nga mënyra e vjeljes së tyre.

2. Do të konsiderohen tatime mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin të gjitha tatimet e vendosura mbi të ardhurat totale, mbi kapitalin në total ose mbi elemente të të ardhurave ose të kapitalit, përfshirë tatimet mbi fitimet nga tjetërsimi i pasurive të luajtshme ose të paluajtshme, tatimet mbi shumën totale të pagave ose shpërblimeve të dhëna nga sipërmarrjet, si edhe tatimet mbi rivlerësimin e kapitalit.

3. Tatimet ekzistuese, ndaj të cilave do të zbatohet Konventa, janë në veçanti:

a) Në Shqipëri:

i) tatimi mbi të ardhurat (përfshirë tatimin mbi fitimin e personave juridikë dhe tatimin mbi të ardhurat personale);

ii) tatimi mbi aktivitetet e biznesit të vogël;

iii) tatimi mbi pasurinë;

(në vijim do t’u referohemi si “tatimet shqiptare”)

b) në Moldavi:

i) tatimi mbi të ardhurat;

ii) tatimi mbi pasurinë e paluajtshme;

(në vijim do t'u referohemi si "tatimet moldave")

4. Konventa do të zbatohet gjithashtu për tatime të njëllajta ose tepër të ngjashme, të cilat do të vendosen pas datës së nënshkrimit të Konventës, si shtojcë ose në vend të tatimeve ekzistuese. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do t'i bëjnë të ditur njëri-tjetrit çdo ndryshim të rëndësishëm që do të bëhet në ligjet e tyre përkatëse tatimore.

Neni 3

Përcaktime të përgjithshme

1. Për qëllimet e kësaj Konvente, përderisa përmbajtja të mos e kërkojë ndryshe:

a) termat "një Shtet Kontraktues" dhe "Shteti tjetër Kontraktues" nënkuptojnë Shqipërinë ose Moldavinë, siç e kërkon përmbajtja;

b) termi "Shqipëria" nënkupton Republikën e Shqipërisë dhe, kur përdoret në sensin gjeografik, nënkupton territorin e Republikës së Shqipërisë, përfshirë ujërat territoriale dhe hapësirën ajrore mbi to, si edhe çdo zonë përtej ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë, e cila, në bazë të ligjeve të saj dhe në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, është një zonë, brenda së cilës Republika e Shqipërisë mund të ushtrojë të drejta lidhur me tabanin detar, nëntokën dhe burimet e tyre natyrore;

c) termi "Moldavia" nënkupton Republikën e Moldavisë dhe, kur përdoret në sensin gjeografik, nënkupton territorin e saj brenda kufijve të saj, përfshirë tokën, nëntokën, hapësirën ujore dhe ajrore mbi tokë dhe ujë, mbi të cilën Republika e Moldavisë ushtron juridiksionin dhe sovranitetin absolut ekskluziv, në përputhje me legjislacionin e saj të brendshëm dhe të drejtën ndërkombëtare;

d) termi "person" përfshin një individ, një shoqëri dhe çdo grup tjetër personash;

e) termi "shoqëri" nënkupton çdo ent ligjor që trajtohet si person juridik për qëllime tatimore;

f) termat "sipërmarrje e një Shteti Kontraktues" dhe "sipërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues" nënkuptojnë respektivisht një sipërmarrje të ushtruar nga një rezident i një Shteti Kontraktues dhe një sipërmarrje të ushtruar nga një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues;

g) termi "nënshtetas" nënkupton:

i) çdo individ që zotëron nënshtetësinë e një Shteti Kontraktues;

ii) çdo person juridik, ortakëri ose shoqatë që gëzojnë statusin si të tillë në përputhje me ligjet në fuqi në një Shtet Kontraktues;

h) termi "trafik ndërkombëtar" nënkupton çdo transport me anije ose një avion, që kryhet nga një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues, përveç kur anija ose avioni vepron vetëm ndërmjet vendeve brenda Shtetit tjetër Kontraktues;

i) termi "autoritet kompetent" nënkupton:

i) në Shqipëri, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;

ii) në Moldavi, Ministrinë e Financave ose përfaqësuesin e autorizuar prej saj.

2. Përsa i përket zbatimit të kësaj Konvente në çdo kohë nga një Shtet Kontraktues, çdo term i papërcaktuar këtu, përderisa përmbajtja të mos e kërkojë ndryshe, do të ketë kuptimin që i është dhënë sipas legjislacionit të atij shteti lidhur me tatimet, ndaj të cilave zbatohet Konventa. Çdo kuptim sipas legjislacionit tatimor të atij shteti ka përparësi ndaj kuptimit të dhënë të atij termi sipas ligjeve të atij shteti.

Neni 4

Rezidenca

1. Për qëllime të kësaj Konvente, termi "rezident i një Shteti Kontraktues" nënkupton çdo person që, sipas ligjeve të atij shteti, është subjekt i tatimeve atje për shkak të vendbanimit, rezidencës, vendit të drejtimit, vendit të regjistrimit apo çdo kriteri tjetër të një natyre të ngjashme, dhe gjithashtu përfshin atë shtet, njësitë administrativo-territoriale ose autoritetet lokale atje. Por, sidoqoftë, ky term nuk përfshin personat që i nënshtrohen tatimit në atë shtet vetëm për të ardhura nga burime në atë shtet apo kapitali i vendosur aty.

2. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1 një individ është rezident i të dy Shteteve Kontraktuese, atëherë statusi i tij do të përcaktohet si vijon:

a) Ai do të konsiderohet rezident vetëm i shtetit në të cilin ai ka bërë një banesë të përhershme në dispozicion të tij. Në qoftë se ai ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij në të dy shtetet, ai

do të konsiderohet rezident vetëm i shtetit, me të cilin interesat e tij personale dhe ekonomike janë të lidhura më ngushtë (qendra e interesave jetike).

b) Në qoftë se shteti, në të cilin ai ka qendrën e interesave jetike, nuk mund të përcaktohet ose në qoftë se ai nuk ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij në asnjërin Shtet, ai do të konsiderohet rezident vetëm i shtetit, në të cilin ai qëndron zakonisht.

c) Në qoftë se ai qëndron rregullisht në të dy shtetet ose në asnjërin prej tyre, ai do të konsiderohet rezident vetëm i shtetit, nënshtetas i të cilit ai është.

d) Në qoftë se ai është nënshtetas i të dy shteteve ose i asnjërit prej tyre, autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do ta zgjidhin këtë çështje me mirëkuptim reciprok.

3. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1 një person joindivid është rezident i të dy Shteteve Kontraktuese, atëherë ai do të konsiderohet rezident vetëm i shtetit në të cilin është vendosur qendra e tij e drejtimit efektiv.

Neni 5

Seli e përhershme

1. Për qëllime të kësaj Konvente, termi “seli e përhershme” nënkupton një vend fiks biznesi, nëpërmjet të cilit ushtrohet tërësisht ose pjesërisht biznesi i një sipërmarrjeje.

2. Termi “seli e përhershme” përfshin në veçanti:

a) një vend drejtimi;

b) një degë;

c) një zyrë;

d) një fabrikë;

e) një punishte,

f) një minierë, një pus naftë ose gazi, një gurore ose çdo vend tjetër për shfrytëzimin e burimeve natyrore.

3. Termi “seli e përhershme” do të përfshijë gjithashtu:

a) një shesh ndërtimi, një konstruksion, projektmontimi ose instalimi, ose projekte mbikëqyrjeje të lidhura me to, por vetëm kur një shesh i tillë, projekte ose aktivitete vazhdojnë për një periudhë prej më shumë se nëntë muaj brenda çdo periudhe dymbëdhjetëmuajore, që fillon ose përfundon në vitin fiskal përkatës;

b) kryerjen e shërbimeve, përfshirë shërbimet e konsulencës nga një sipërmarrje nëpërmjet të punësuarve ose edhe personeli tjetër të zënë me punë, nga sipërmarrja për këtë qëllim, por vetëm kur aktivitete të kësaj natyre vazhdojnë brenda vendit për një periudhë ose periudha që në total i kalojnë tre muaj brenda çdo periudhe dymbëdhjetëmuajore, që fillon ose përfundon në vitin fiskal përkatës.

4. Pavarësisht nga dispozitat e mëparshme të këtij neni termi “seli e përhershme” nuk do të përfshijë:

a) përdorimin e pajisjeve ose objekteve vetëm për qëllime magazinimi ose ekspozimi të mallrave që i përkasin sipërmarrjes;

b) mbajtjen e një gjendjeje mallrash që i përkasin sipërmarrjes vetëm për qëllime magazinimi ose ekspozimi;

c) mbajtjen e një gjendjeje mallrash që i përkasin sipërmarrjes vetëm për qëllime përpunimi nga një sipërmarrje tjetër;

d) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm me qëllim blerjen e mallrave ose për mbledhje informacioni për sipërmarrjen;

e) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për qëllim të ushtrimit, për sipërmarrjen, të çdo aktiviteti tjetër me karakter përgatitor ose ndihmës.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, kur një person, i ndryshëm nga një agjent me status të pavarur, ndaj të cilit zbatohet paragrafi, vepron në një Shtet Kontraktues në emër të një sipërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues, kjo sipërmarrje do të konsiderohet se ka një seli të përhershme në Shtetin Kontraktues të përmendur në fillim lidhur me çdo aktivitet që ai person ndërmerr për sipërmarrjen, në qoftë se ky person:

a) ka dhe zakonisht e ushtron në shtetin e përmendur në fillim një autoritet për të përfunduar kontrata në emër të sipërmarrjes, përveç kur aktivitetet e këtyre personave kufizohen në ato të përmendura në paragrafin 4, të cilat, edhe pse ushtrohen nëpërmjet një vendi fiks biznesi, nuk e bëjnë

këtë vend fiks biznesi një seli të përhershme sipas dispozitave të atij paragrafi;

b) nuk ka një autoritet të tillë, por zakonisht mban në shtetin e përmendur në fillim një gjendje mallrash, nga i cila ai shpërndan rregullisht mallra në emër të sipërmarrjes.

6. Një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues nuk do të konsiderohet se ka një seli të përhershme në Shtetin tjetër Kontraktues vetëm për faktin se ajo ushtron biznes në këtë shtet tjetër nëpërmjet një ndërmjetësi, komisioneri të përgjithshëm apo çdo lloj agjenti tjetër me një status të pavarur, me kusht që të tillë persona veprojnë brenda kuadrit të zakonshëm të aktivitetit të tyre. Sidoqoftë, kur aktivitetet e një agjenti të tillë kryhen tërësisht ose pothuajse tërësisht në emër të asaj sipërmarrjeje, ai nuk do të konsiderohet një agjent me një status të pavarur brenda kuptimit të këtij paragrafi.

7. Pavarësisht nga dispozitat e mëparshme të këtij neni, një sipërmarrje sigurimi e një Shteti Kontraktues, do të konsiderohet, me përjashtim të aktivitetit të risigurimit, se ka seli të përhershme në Shtetin tjetër Kontraktues, nëse mbledh prime në territorin e këtij shteti tjetër ose siguron nga rreziqet atje nëpërmjet një personi të ndryshëm nga një agjent me status të pavarur, ndaj të cilit aplikohet paragrafi 6.

8. Fakti që një shoqëri që është rezidente e një Shteti Kontraktues kontrollon ose kontrollohet nga një shoqëri që është rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues ose që ushtron aktivitet në atë Shtet tjetër (nëpërmjet një selie të përhershme ose në forma të tjera) nuk përbën në vetvete arsye të mjaftueshme për të konsideruar një shoqëri seli të përhershme të tjetrës.

Neni 6

Të ardhurat nga pasuria e paluajtshme

1. Të ardhurat e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga pasuri të paluajtshme (përfshirë të ardhurat nga bujqësia dhe pyjet) të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

2. Termi “pasuri e paluajtshme” do të ketë kuptimin që ka sipas ligjit të Shtetit Kontraktues ku është vendosur prona në fjalë. Në çdo rast ky term do të përfshijë pasuritë aksesore të pasurisë së paluajtshme, inventarin e gjallë dhe pajisjet e përdorura në bujqësi e në pyje, të drejtat ndaj të cilave zbatohen dispozitat e legjislacionit të përgjithshëm lidhur me pronën mbi tokë, uzufukti i pasurive të paluajtshme dhe të drejtat ndaj pagesave fikse ose variabël për shfrytëzimin ose të drejtën për të shfrytëzuar vendburimet minerare dhe burime e pasuri të tjera natyrore. Anijet dhe avionët nuk konsiderohen pasuri të paluajtshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen ndaj të ardhurave të realizuara nga përdorimi direkt, dhënia me qira ose përdorimi në çdo formë tjetër i pasurive të paluajtshme.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 3 do të zbatohen gjithashtu ndaj të ardhurave nga pasuria e paluajtshme e një sipërmarrjeje dhe ndaj të ardhurave nga pasuria e paluajtshme e përdorur për kryerjen e shërbimeve personale të pavarura.

Neni 7

Fitimet nga biznesi

1. Fitimet e një sipërmarrjeje të një Shteti Kontraktues do të takohen vetëm në atë shtet, përveç kur sipërmarrja ushtron aktivitet në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty. Në qoftë se sipërmarrja ushtron aktivitetin në mënyrën e sipërpërmendur, fitimet e sipërmarrjes mund të tatohen në shtetin tjetër, por vetëm ajo pjesë e tyre që i atribuohet:

a) asaj selie të përhershme;

b) shitjeve në atë shtet tjetër të mallrave njëloj ose në mënyrë të ngjashme si shitjet nëpërmjet selisë së përhershme;

c) aktiviteteve të tjera të biznesit të ushtruara në këtë shtet tjetër njëloj ose në mënyrë të ngjashme me ato të ushtruara nëpërmjet kësaj selie të përhershme.

2. Pa cenuar dispozitat e paragrafit 3, kur një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, atëherë në secilin Shtet Kontraktues, selisë së përhershme do t'i atribuohen fitimet që ajo do të realizonte, nëse ajo do të ishte një sipërmarrje e veçantë dhe e pavarur, që do të vepronte në të njëjtin ose në aktivitete të ngjashme në kushte të njëjta ose të ngjashme dhe tërësisht e pavarur nga sipërmarrja, seli e

përhershme e së cilës ajo është.

3. Në përcaktimin e fitimeve të një selie të përhershme, do të lejohet zbritja e shpenzimeve që janë kryer për qëllimet e aktivitetit të selisë së përhershme, përfshirë shpenzimet e përgjithshme administrative dhe ekzekutive si në shtetin ku ndodhet selia e përhershme, ashtu edhe gjetkë. Megjithatë, nuk do të trajtohen si shpenzime të zbritshme shumat, nëse ka, të paguara (përveç atyre për rimbursime të shpenzimeve të kryera) nga një seli e përhershme për zyrën qendrore të sipërmarrjes apo për ndonjë zyrë tjetër të saj, si honorare apo pagesa të tjera të ngjashme si shpërblim për përdorim patentash apo të drejta të tjera, ose si komisione për shërbime të veçanta të kryera për menaxhim, ose përveç rastit të sipërmarrjeve bankare, si interesa të huave dhënë selisë së përhershme. Në të njëjtën mënyrë, nuk do të merren parasysh në përcaktimin e fitimeve të selisë së përhershme, për shumata të ngarkuara (përveç atyre për rimbursime të shpenzimeve të kryera) nga ana e selisë së përhershme për zyrën qendrore të sipërmarrjes apo për ndonjë zyrë tjetër të saj, si honorare apo pagesa të tjera të ngjashme si shpërblim për përdorim patentash apo të drejta të tjera, ose si komisione për shërbime të veçanta të kryera apo për menaxhim, ose, përveç rastit të sipërmarrjeve bankare, si interesa të huave dhënë zyrës qendrore të sipërmarrjes ose ndonjë zyre tjetër të saj.

4. Përderisa në njërin prej Shteteve Kontraktuese përcaktimi i fitimeve që i atribuohen një selie të përhershme bëhet zakonisht me metodën e ndarjes së fitimeve të përgjithshme të sipërmarrjes midis pjesëve të veçanta të saj, dispozitat e paragrafit 2 nuk e pengojnë atë Shtet Kontraktues të përcaktojë fitimet e tatueshme në bazë të kësaj metode, siç bëhet zakonisht, megjithatë rezultati i kësaj metode duhet të jetë konform parimeve që përmban ky nen.

5. Asnjë fitim nuk do t'i atribuohet një selie të përhershme vetëm për faktin se ajo blen mallra nëpërmjet kësaj selie të përhershme për sipërmarrjen.

6. Për qëllimet e paragrafëve të mësipërm, fitimet që do t'i atribuohen selisë së përhershme do të përcaktohen me të njëjtën metodë çdo vit, përderisa të mos ketë arsye të forta dhe të mjaftueshme për të proceduar ndryshe.

7. Kur fitimet përmbajnë elemente të të ardhurave që trajtohen veças në nene të tjera të kësaj Konvente, atëherë dispozitat e atyre neneve nuk do të ndikohen nga dispozitat e këtij neni.

Neni 8

Transporti ndërkombëtar

1. Fitimet e një sipërmarrjeje të një Shteti Kontraktues nga veprimtaria e anijeve ose avionëve në trafikun ndërkombëtar do të taten vetëm në atë shtet.

2. Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen gjithashtu ndaj fitimeve nga pjesëmarrja në një ortakëri, një biznes të përbashkët ose në një agjenci ndërkombëtare transporti.

Neni 9

Sipërmarrje të lidhura

1. Kur:

a) një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues merr pjesë direkt ose indirekt në drejtimin, kontrollin ose kapitalin e një sipërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues ose

b) të njëjtët persona marrin pjesë direkt ose indirekt në drejtimin, kontrollin apo kapitalin e një sipërmarrjeje të një Shteti Kontraktues dhe të një sipërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues,

dhe në secilin rast kushtet që janë pranuar ose që janë vendosur midis dy sipërmarrjeve në marrëdhëniet e tyre tregtare ose financiare ndryshojnë nga ato që do të vendoseshin midis sipërmarrjeve të pavarura, atëherë çdo fitim që duhej të realizohej nga njëra sipërmarrje, por, për shkak të këtyre kushteve nuk është realizuar, mund të përfshihet në fitimet e asaj sipërmarrjeje dhe të taten normalisht.

2. Kur një Shtet Kontraktues përfshin në fitimet e një sipërmarrjeje të atij shteti, dhe i taton normalisht, fitime mbi të cilat një sipërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues është ngarkuar me tatim në atë shtet tjetër dhe fitimet e përfshira në këtë mënyrë janë fitime që do të ishin realizuar nga sipërmarrja e shtetit të përmendur në fillim, nëse kushtet e vendosura ndërmjet dy sipërmarrjeve do të ishin ato që do të vendoseshin ndërmjet sipërmarrjeve të pavarura, atëherë ai shtet tjetër do të bëjë rregullimin e duhur në shumën e tatimit të ngarkuar në atë shtet mbi ato fitime, kur ai shtet tjetër e

konsideron të justifikuar rregullimin. Në përcaktimin e rregullimeve të tilla, do të respektohen edhe dispozitat e tjera të kësaj Konvente dhe autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese, në rast nevojë, do të konsultohen me njëri-tjetrin.

Neni 10 **Dividentët**

1. Dividentët e paguar nga një shoqëri, që është rezidente e një Shteti Kontraktues, një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në atë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto dividendë mund të tatohen edhe në Shtetin Kontraktues, rezidente e të cilit është kompania paguese e dividendëve dhe në përputhje me ligjet e këtij shteti, por, nëse pronari përfitues i dividendëve është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i ngarkuar nuk do të kalojë:

a) 5 për qind të shumës bruto të dividendëve, nëse pronari përfitues është një shoqëri (joortakëri) që zotëron direkt të paktën 25 për qind të kapitalit të shoqërisë paguese të dividendëve;

b) 10 për qind të shumës bruto të dividendëve, në të gjitha rastet e tjera.

Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të vendosin me mirëkuptim reciprok mënyrën e zbatimit të këtyre kufizimeve.

Ky paragraf nuk do të ketë efekt mbi tatimin e shoqërisë lidhur me fitimet prej të cilave janë paguar dividendët.

3. Termi “dividentë” në përdorimin në këtë nen nënkupton të ardhurat nga aksionet e çdo lloji apo të drejta të tjera që nuk janë kërkesa borxhi, pjesëmarrja në fitime, si edhe të ardhura nga të drejta të tjera të shoqërisë, që i nënshtrohen të njëjtit trajtim tatimor si të ardhurat nga aksionet nga ligjet e shtetit, rezidente e të cilit është shoqëria që bën shpërndarjen e dividendëve.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i dividendëve, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues, rezidente e të cilit është kompania paguese e dividendëve, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty ose ushtron në këtë Shtet shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur atje dhe zotërimi, lidhur me të cilin janë paguar dividendët, është efektivisht i lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14, sipas rastit.

5. Kur një shoqëri që është rezidente e një Shteti Kontraktues realizon fitime ose të ardhura nga Shteti tjetër Kontraktues, ky shtet tjetër mund të mos aplikojë tatim mbi dividendët e paguar nga shoqëria, përveç kur këto dividendë i paguhen një rezidenti të shtetit tjetër ose kur zotërimi, lidhur me të cilin janë paguar dividendët, është efektivisht i lidhur me një seli të përhershme ose bazë fikse të vendosur në këtë shtet tjetër, gjithashtu subjekt i tatimit mbi fitimet e pashpërndara të shoqërisë nuk janë as fitimet e pashpërndara të shoqërisë, edhe sikur dividendët e paguar ose fitimet e pashpërndara konsistojnë tërësisht ose pjesërisht si fitime apo të ardhura të realizuara në këtë shtet tjetër.

Neni 11 **Interesat**

1. Interesat që krijohen në një Shtet Kontraktues dhe i paguhen një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në atë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto interesa mund të tatohen edhe në Shtetin Kontraktues ku ato krijohen dhe në përputhje me ligjet e atij shteti, por, nëse pronari përfitues i interesave është një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i zbatuar nuk duhet të kalojë 5 për qind të shumës bruto të interesit.

Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të zgjidhin me mirëkuptim reciprok mënyrën e zbatimit të këtij kufizimi.

3. Termi “interesa” në kuptimin e përdorur në këtë nen nënkupton të ardhurat nga kërkesat e borxhit të çdo lloji, të siguruara ose jo me hipotekim dhe që e kanë ose jo të drejtën e pjesëmarrjes në fitimet e debitorit dhe në veçanti të ardhurat nga obligacionet qeveritare dhe të ardhurat nga letrat me vlerë ose huatë, duke përfshirë fitimet dhe çmimet e lidhura me këto obligacione, letra me vlerë ose hua. Gjjobat e ngarkuara për pagesat e vonuara nuk do të trajtohen si interesa për qëllime të këtij neni.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen në qoftë se pronari përfitues i interesave, duke qenë një rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues ku krijohen interesat, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, ose ushtron në

këtë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur atje dhe kërkesa e huasë lidhur me të cilën paguhet interesi është efektivisht e lidhur me: a) këtë seli të përhershme apo bazë fikse ose me b) aktivitete biznesi që i referohen nënparagrafit (c) të paragrafit 1 të nenit 7. Në këto raste do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14, sipas rastit.

5. Interesat do të konsiderohen se krijohen në një Shtet Kontraktues kur pagues është një rezident i atij shteti. Megjithatë, kur personi që paguan interesat, qoftë ose jo rezident i njërit Shtet Kontraktues, ka në një Shtet Kontraktues një seli të përhershme ose bazë fikse në lidhje me të cilën ka lindur huaja për të cilën paguhet interesi dhe këto interesa krijohen nga selia e përhershme ose baza fikse, atëherë këto interesa do të konsiderohen se janë krijuar në shtetin ku është vendosur selia e përhershme ose baza fikse.

6. Kur për shkak të lidhjeve të veçanta ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues të interesave ose ndërmjet të dyve dhe personave të tretë, shuma e interesave, bazuar në kërkesën e borxhit për të cilën ato paguhet, e kalon shumën mbi të cilën duhej të ishte rënë dakord ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues në mungesë të lidhjeve të tilla të veçanta, dispozitat e këtij neni do të zbatohen vetëm mbi shumën e përmendur në fund. Në këtë rast, pjesa që kalon pagesën normale do të mbetet e tatueshme në përputhje me ligjet e secilit Shtet Kontraktues, duke pasur parasysh edhe dispozitat e tjera të kësaj Konvente.

Neni 12 **Honoraret**

1. Honoraret që krijohen në një Shtet Kontraktues dhe i paguhet një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të taten në atë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto të ardhura mund të taten gjithashtu në Shtetin Kontraktues ku krijohen dhe në përputhje me ligjet e këtij shteti, por nëse pronari përfitues i honorareve është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i ngarkuar nuk duhet të kalojë 10 për qind të shumës bruto të honorarit.

Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të vendosin me mirëkuptim reciprok për mënyrën e zbatimit të këtij kufizimi.

3. Termi “honorare” nën dispozitat e këtij neni nënkupton pagesat e çdo lloji të marra si shpërblim për përdorimin ose të drejtën e përdorimit të së drejtës së autorit për punimet letrare, artistike ose shkencore, përfshirë filmat kinematografikë dhe filmat e kasetat për transmetime radio-televizive, çdo patentë, programe kompjuterike, markë tregtare, skicë ose model, plan, proces ose formulë sekrete, ose për informacione lidhur me eksperiencën industriale tregtare ose shkencore.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i honorareve, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues ku krijohen honoraret, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, ose kryen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur aty, dhe e drejta ose prona për të cilën paguhet honoraret është efektivisht e lidhur me: a) këtë seli të përhershme ose bazë fikse ose b) aktivitete biznesi që i referohen nënparagrafit (c) të paragrafit 1 të nenit 7. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14, sipas rastit.

5. Honoraret do të konsiderohen se krijohen në një Shtet Kontraktues kur pagues është një rezident i atij shteti. Megjithatë, kur personi që paguan honoraret, qoftë ose jo rezident i një Shteti Kontraktues, ka në një Shtet Kontraktues një seli të përhershme ose një bazë fikse, në lidhje me të cilën ka lindur e drejta e pagimit të honorareve dhe këto honorare kanë lindur nga kjo seli e përhershme ose bazë fikse, atëherë këto honorare do të konsiderohen se kanë lindur në Shtetin Kontraktues ku ndodhet selia e përhershme ose baza fikse.

6. Kur për shkak të lidhjeve të veçanta ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues të honorareve ose midis të dyve dhe personave të tretë, shuma e honorareve, duke pasur parasysh përdorimin, të drejtën apo informacionin për të cilin ato janë paguar, e kalon shumën për të cilën do të ishte rënë dakord ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues në mungesë të marrëdhënieve të tilla, atëherë dispozitat e këtij neni do të zbatohen vetëm mbi shumën e përmendur në fund. Në një rast të tillë pjesa e shpërblimit që kalon shpërblimin normal mbetet e tatueshme sipas ligjeve përkatëse të secilit Shtet Kontraktues, duke pasur parasysh dispozitat e tjera të kësaj Konvente.

Neni 13
Fitimet nga kapitali

1. Fitimet e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga tjetërsimi i pasurive të paluajtshme që i referohen nenit 6 dhe të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të taten në atë shtet tjetër.

2. Fitimet nga tjetërsimi i pasurive të paluajtshme që bëjnë pjesë në pasuritë e biznesit të një selie të përhershme, që një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues ose pasurive të luajtshme që i përkasin një baze fikse që një rezident i një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues për të kryer shërbime personale të pavarura, përfshirë edhe fitimet nga tjetërsimi i vetë selisë së përhershme (vetëm ose bashkë me sipërmarrjen) ose i bazës fikse, mund të taten në këtë shtet tjetër.

3. Fitimet e realizuara nga një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues nga tjetërsimi i anijeve ose avionëve, që veprojnë në trafikun ndërkombëtar ose i pasurive të luajtshme që i përkasin veprimtarisë së këtyre anijeve ose avionëve do të taten vetëm në atë shtet.

4. Fitimet nga tjetërsimi i aksioneve të kapitalit të një shoqërie ose i pjesëmarrjes në një ortakëri ose kompani, pasuria e së cilës konsiston direkt ose indirekt kryesisht në pasuri të paluajtshme të vendosura në një Shtet Kontraktues, mund të taten në atë Shtet Kontraktues.

5. Fitimet nga tjetërsimi i çdo pasurie që nuk mbulohet nga paragrafët e mësipërm të këtij neni, do të taten vetëm në Shtetin Kontraktues, rezident i të cilit është tjetërsuesi.

Neni 14
Shërbimet personale të pavarura

1. Të ardhurat e realizuara nga një individ që është rezident i një Shteti Kontraktues lidhur me shërbimet profesionale ose shërbime të tjera të ngjashme të një karakteri të pavarur do të taten vetëm në atë shtet, përveç kur puna është ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues. Nëse puna ushtrohet në këtë Shtet tjetër Kontraktues:

a) kur ai ka një bazë fikse në dispozicion të tij në Shtetin tjetër Kontraktues që rregullisht i shërben atij për të kryer aktivitetet e tij; në këtë rast, vetëm ajo pjesë e të ardhurave që i atribuohet kësaj baze fikse mund të taten në këtë shtet tjetër;

b) nëse qëndrimi i tij në Shtetin tjetër Kontraktues është për një periudhë ose periudha që në total arrijnë ose i kalojnë 183 ditë në çdo periudhë dymbëdhjetë mujore që fillon ose përfundon në vitin përkatës fiskal; në këtë rast, vetëm ajo pjesë e të ardhurave e realizuar nga aktivitetet e tij të kryera në këtë Shtet tjetër mund të taten në këtë Shtet tjetër.

2. Termi “shërbime profesionale” përfshin në veçanti aktivitetet e pavarura shkencore, letrare, artistike, arsimore apo të mësimdhënies, si dhe aktivitetet e pavarura të mjekëve, dentistëve, avokatëve, inxhinierëve, arkitektëve, llogaritarëve, kontrollorëve dhe këshilltarëve.

Neni 15
Të ardhurat nga punësimi

1. Pa cenuar dispozitat e neneve 16, 18 dhe 19, pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme, që përfitohen nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga punësimi i tij do të taten vetëm në këtë shtet, përveç kur puna është ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues. Nëse puna ushtrohet në këtë mënyrë, atëherë këto të ardhura mund të taten në këtë shtet tjetër.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, të ardhurat e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues lidhur me punën e ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues do të taten vetëm në shtetin e përmendur në fillim në qoftë se:

a) përfituesi është prezent në shtetin tjetër për një periudhë ose periudha që nuk i kalojnë në total 183 ditë në çdo periudhë dymbëdhjetë mujore që fillon ose përfundon në vitin fiskal përkatës;

b) shpërblimi paguhet nga, ose në emër të një punëdhënësi që nuk është rezident i shtetit tjetër;

c) shpërblimi nuk ka lindur nga një seli e përhershme ose bazë fikse që punëdhënësi ka në shtetin tjetër.

3. Pavarësisht nga dispozitat e mëparshme të këtij neni, shpërblimet e përfituara lidhur me punën e ushtruar në bordin e një anije ose avioni që operon në trafikun ndërkombëtar nga një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues mund të tatohen në këtë shtet.

Neni 16

Shpërblimet e drejtorëve

Shpërblimet e drejtorëve dhe pagesa të tjera të ngjashme të realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues në pozitën e tij si anëtar i bordit të drejtorëve ose çdo organi të ngjashëm të një shoqërie që është rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

Neni 17

Artistët dhe sportistët

1. Pavarësisht nga dispozitat e neneve 14 dhe 15 të ardhurat e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues si një artist, si aktor teatri, kinematografie, radiotelevizioni, si muzikant ose sportist, nga aktivitetet e tij personale si të tilla, të ushtruara në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

2. Kur të ardhurat lidhur me aktivitetet personale të ushtruara nga një artist ose sportist në pozitën e tij si i tillë që nuk realizohen direkt nga sportisti ose artisti, por nga një person tjetër, këto të ardhura, pavarësisht nga dispozitat e neneve 7, 14 dhe 15, mund të tatohen në Shtetin Kontraktues, në të cilin janë ushtruar aktivitetet e artistit ose sportistit.

Neni 18

Pensionet

Pa cenuar dispozitat e paragrafit 2 të nenit 19, pensionet dhe shpërblime të tjera të ngjashme paguar një rezidenti të një Shteti Kontraktues, lidhur me punësimin e tij në të kaluarën, do të tatohen vetëm në atë shtet.

Neni 19

Shërbimet qeveritare

1. a) Rrogat dhe pagat, si edhe shpërblime të tjera të ngjashme të ndryshme nga pensionet, të paguara nga një Shtet Kontraktues, njësi administrativo-territoriale ose nga një autoritet lokal atje, një individ lidhur me shërbimet e kryera atij shteti, njësie ose autoriteti do të tatohen vetëm në atë shtet.

b) Megjithatë, këto rroga, paga dhe shpërblime të tjera të ngjashme do të tatohen vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues, nëse shërbimet janë kryer në atë shtet dhe individ është rezident i atij shteti, i cili:

i) është nënshetetas i atij shteti;

ii) nuk është bërë rezident i atij shteti vetëm për qëllim të kryerjes së shërbimeve.

2. a) Çdo pension i paguar nga, ose prej fondeve të krijuara nga një Shtet Kontraktues, njësi territoriale-administrative ose autoritet lokal atje një individ lidhur me shërbimet e kryera atij Shteti, njësie ose autoriteti do të tatohen vetëm në atë shtet.

b) Megjithatë, këto pensione do të tatohen vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues, nëse individ është rezident dhe nënshetetas i këtij shteti.

3. Dispozitat e neneve 15, 16 dhe 18 do të zbatohen mbi rrogat, pagat, si edhe shpërblime të tjera të ngjashme dhe mbi pensionet, lidhur me shërbimet e kryera lidhur me një aktivitet biznesi të ushtruar nga një Shtet Kontraktues, njësi administrativo-territoriale ose një autoritet lokal atje.

Neni 20

Studentët

Një student ose specializant që është ose ishte rezident i një Shteti Kontraktues menjëherë përpara vajtjes në Shtetin tjetër Kontraktues dhe që është prezent në Shtetin tjetër Kontraktues vetëm

për qëllim të arsimimit ose trajnimit të tij, për pagesat që merr për qëllim të jetesës, shkollimit ose trajnimit nuk do të tatohet në këtë shtet tjetër, me kusht që këto pagesa të kryhen nga burime jashtë këtij shteti.

Neni 21

Të ardhura të tjera

1. Lloje të të ardhurave të një rezidenti të një Shteti Kontraktues, kudo që të krijohen, që nuk lidhen me nenet e mëparshëm të kësaj Konvente, do të tatohen vetëm në atë shtet.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk do të zbatohen ndaj të ardhurave, të ndryshme nga të ardhurat nga pasuria e paluajtshme të përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 6, nëse përfituesi i këtyre të ardhurave, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron aktivitet në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, ose kryen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur aty, dhe e drejta ose pasuria lidhur me të cilën paguhet shpërblimi është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose 14 sipas rastit.

Neni 22

Kapitali

1. Kapitali i përfaqësuar nga pasuri të paluajtshme të referuara në nenin 6, të zotëruara nga një rezident i një Shteti Kontraktues dhe të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

2. Kapitali i përfaqësuar nga pasuri të luajtshme, që bëjnë pjesë në pasurinë biznesore të një selie të përhershme që një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues ose nga pasuri të luajtshme që i përkasin një baze fikse në dispozicion të një rezidenti të një Shteti Kontraktues në Shtetin tjetër Kontraktues për kryerjen e shërbimeve personale të pavarura, mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

3. Kapitali i përfaqësuar nga anije dhe avionë, që operohen nga një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues në trafikun ndërkombëtar, si dhe nga pasuritë e luajtshme që i përkasin aktivitetit të këtyre anijeve dhe avionëve do të tatohen vetëm në këtë shtet.

4. Të gjitha elementet e tjera të kapitalit të një rezidenti të një Shteti Kontraktues do të tatohen vetëm në atë shtet.

Neni 23

Eliminimi i tatimit të dyfishtë

1. Kur një rezident i një Shteti Kontraktues realizon të ardhura ose zotëron kapitale të cilat, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, mund të tatohen në Shtetin tjetër Kontraktues, shteti i përmendur në fillim do të lejojë:

a) një reduktim nga tatimi mbi të ardhurat e atij rezidenti, të një shume të barabartë me tatimin mbi të ardhurat të paguara në atë shtet tjetër;

b) një reduktim nga tatimi mbi kapitalin e atij rezidenti, të një shume të barabartë me tatimin mbi kapitalin të paguar në atë shtet tjetër.

Megjithatë, në secilin rast, ky reduktim nuk do të kalojë atë pjesë të tatimit mbi të ardhurat ose kapitalin e llogaritur para dhënies së reduktimit, që i atribuohet, sipas rastit, të ardhurave ose kapitalit që mund të tatohen në atë shtet tjetër.

2. Kur në përputhje me dispozitat e Konventës, të ardhurat e realizuara ose kapitali i zotëruar nga një rezident i një Shteti Kontraktues përjashtohen nga tatimi në atë shtet, megjithatë, në llogaritjen e shumës së tatimit mbi të ardhurat ose kapitalin e mbetur të këtij rezidenti, ai shtet merr parasysh të ardhurat ose kapitalin e përjashtuar.

Neni 24

Mosdiskriminimi

1. Nënshtetaset e një Shteti Kontraktues nuk do të jenë në Shtetin tjetër Kontraktues subjekt i ndonjë tatimi ose kërkesë të lidhur me të, që të jetë i ndryshëm ose më i rëndë se sa tatimi ose kërkesat e lidhura me të, të cilave i nënshtrohen nënshtetaset e këtij shteti tjetër në rrethana të njëjta, në veçanti lidhur me rezidencën. Kjo dispozitë, pavarësisht nga dispozitat e nenit 1, do të zbatohet gjithashtu ndaj personave që nuk janë rezidentë të njërit ose të asnjërit prej Shteteve Kontraktuese.

2. Tatimi i një selie të përhershme që një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues nuk do të jetë më pak i favorshëm në këtë shtet tjetër, sesa tatimi i ngarkuar ndaj sipërmarrjeve të këtij shteti tjetër që ushtrojnë aktivitete të njëjta. Kjo dispozitë nuk do të merret si detyrim i njërit Shtet Kontraktues për t'u garantuar rezidentëve të Shtetit tjetër Kontraktues lehtësime personale dhe reduktime tatimore që i garanton rezidentëve të shtetit të vet, për shkak të gjendjes civile dhe përgjegjësisive familjare që ata kanë.

3. Përfshijtur rastet kur zbatohen dispozitat e paragrafit 1 të nenit 9, paragrafit 6 të nenit 11, ose paragrafit 6 të nenit 12, interesat, honoraret dhe shpërblime të tjera të paguara nga një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, për efekt të përcaktimit të fitimeve të tatueshme të kësaj sipërmarrjeje, do të jenë të reduktueshme nën të njëjtat kushte njëjloj sikur ato t'i paguheshin një rezidenti të shtetit të përmendur në fillim. Në mënyrë të ngjashme, çdo borxh i një sipërmarrjeje të një Shteti Kontraktues ndaj një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, për efekt të përcaktimit të kapitalit të tatueshëm të kësaj sipërmarrjeje, do të jetë i reduktueshëm nën të njëjtat kushte njëjloj sikur sipërmarrja të kishte kontraktuar me një rezident të shtetit të përmendur në fillim.

4. Sipërmarrjet e një Shteti Kontraktues, kapitali i të cilave është totalisht ose pjesërisht i zotëruar ose kontrolluar direkt ose indirekt nga një ose më shumë rezidentë të Shtetit tjetër Kontraktues, nuk do të jenë në shtetin e përmendur në fillim subjekt i ndonjë tatimi ose kërkesë të lidhur me të, që të jetë tjetër ose më i rëndë sesa tatimi ose kërkesat e lidhura me të, të cilave i nënshtrohen sipërmarrje të tjera të ngjashme të shtetit të përmendur në fillim.

Neni 25

Procedura e mirëkuptimit reciprok

1. Kur një person mendon se veprimet e njërit ose të dy Shteteve Kontraktuese e rëndojnë ose do ta rëndojnë atë me tatime që nuk janë në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, pavarësisht nga mënyra e ankimit të parashikuara në legjislacionin e brendshëm të këtyre shteteve, ai mund t'ua paraqesë rastin e tij autoriteteve kompetente të Shtetit Kontraktues, rezident i të cilit ai është, ose nëse rasti lidhet me paragrafin 1 të nenit 24, ai mund t'ia paraqesë atë Shtetit Kontraktues, nënshtetas i të cilit ai është. Çështja duhet të paraqitet brenda tre vjetëve nga njoftimi i parë lidhur me tatimin që nuk është në përputhje me dispozitat e Konventës.

2. Autoriteti kompetent, nëse kërkesa i duket e justifikuar dhe ai vetë nuk e ka të mundur arritjen e një zgjidhje të kënaqshme, do të përpiqet ta zgjidhë çështjen me mirëkuptim reciprok me autoritetin kompetent të Shtetit tjetër Kontraktues, me synim shmangien e tatimit që nuk është në përputhje me Konventën. Çdo marrëveshje e arritur do të zbatohet pavarësisht nga kufijtë kohorë që mund të parashikojë legjislacioni i brendshëm i Shteteve Kontraktuese.

3. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të përpiqen që me mirëkuptim reciprok të zgjidhin çdo vështirësi ose dyshim që lind nga interpretimi ose zbatimi i Konventës. Ato gjithashtu mund të konsultohen së bashku për eliminimin e tatimit të dyfishtë në rastet kur një gjë e tillë nuk parashikohet nga Konventa.

4. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese mund të komunikojnë me njëri-tjetrin direkt, përfshirë edhe takimet nëpërmjet komisioneve të përbashkëta të përbëra prej tyre ose përfaqësuesve të tyre, për arritjen e mirëkuptimit në kuptimin e paragrafëve të mësipërm.

Neni 26

Shkëmbimi i informacionit

1. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të shkëmbejnë informacionet e nevojshme për zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente ose të ligjeve të brendshme të Shteteve Kontraktuese lidhur me tatimet që mbulon Konventa, përderisa ato tatime nuk janë në kundërshtim me Konventën. Shkëmbimi i informacionit nuk kufizohet nga nenet 1 dhe 2 të kësaj Konvente. Çdo

informacion i marrë nga një Shtet Kontraktues do të trajtohet si sekret, në të njëjtën mënyrë si informacioni i marrë nën legjislacionin e brendshëm të atij shteti dhe do t'u serviret vetëm personave ose autoriteteve (përfshirë gjykatat dhe organet administrative) të përfshira në llogaritjen ose mbledhjen e tatimeve, me imponimin ose ndjekjet lidhur me shkeljet tatimore ose lidhur me ankesat ndaj tatimeve që mbulon Konventa. Këto persona ose autoritete do ta përdorin informacionin vetëm për të tilla qëllime. Ato mund ta servirin informacionin në procedurat ose vendimet gjyqësore.

2. Në asnjë rast dispozitat e paragrafit 1 nuk do të interpretohen në kuptimin që i imponojnë njërit prej Shteteve Kontraktuese detyrimin:

a) të zbatojnë masa administrative në ndryshim me ligjet dhe praktikën administrative të atij ose të Shtetit tjetër Kontraktues;

b) të japë informacione që ndalohen sipas ligjeve dhe praktikës normale administrative të atij ose të Shtetit tjetër Kontraktues;

c) të japë informacione që mund të nxirrnin një sekret tregtar, biznesor, industrial, komercial ose profesional apo informacione, komunikimi i të cilave do të ishte në kundërshtim me politikën publike (rendin publik).

Neni 27

Funksionarët e misioneve diplomatike dhe konsullore

Dispozitat e kësaj Konvente nuk cenojnë privilegjet fiskale të funksionarëve diplomatikë dhe konsullorë që rrjedhin nga rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare apo nga dispozita të marrëveshjeve të veçanta.

Neni 28

Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi në datën e njoftimit me shkrim, më të vonshëm, nëpërmjet kanaleve diplomatike, i cili konfirmon plotësimin nga Shtetet Kontraktuese të procedurave të kërkuara prej ligjeve të tyre për hyrjen në fuqi të Konventës dhe dispozitat e saj do të kenë efekt:

a) lidhur me tatimet e mbajtura në burim, mbi të ardhurat e realizuara më ose pas 1 janarit të vitit kalendarik që pason vitin në të cilin kjo Konventë hyn në fuqi;

b) lidhur me tatimet e tjera mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin, ndaj tatimeve të pagueshme për çdo vit kalendarik që fillon më ose pas 1 janarit të vitit kalendarik që pason vitin në të cilin Konventa hyn në fuqi.

Neni 29

Përfundimi

Kjo Konventë do të mbetet në fuqi deri në përfundimin nga njëri Shtet Kontraktues. Secili Shtet Kontraktues mund të përfundojë Konventën nëpërmjet kanaleve diplomatike, duke dhënë njoftimin me shkrim të përfundimit të paktën gjashtë muaj përpara përfundimit të çdo viti kalendarik, që fillon pas mbarimit të një periudhe pesë-vjeçare nga data e hyrjes në fuqi të Konventës. Në rast të tillë, Konventa do të pushojë së pasuri efekt:

a) lidhur me tatimet e mbajtura në burim, mbi të ardhurat e realizuara më ose pas 1 janarit të vitit tjetër kalendarik që ndjek vitin në të cilin është dhënë njoftimi i përfundimit;

b) lidhur me tatimet e tjera mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin, për çdo vit tatimor që fillon më 1 janar të vitit tjetër kalendarik që ndjek vitin në të cilin është dhënë njoftimi i përfundimit.

Nënshkruesit, në praninë dhe të autorizuar në mënyrën e duhur, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Porto/Portugali, më 6 dhjetor 2002, në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe, moldave dhe angleze, të dy tekstet origjinale kanë vlera të barabarta. Në raste kontradiktash midis teksteve, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PROTOKOLL

Në momentin e nënshkrimit të Konventës midis Qeverisë së Republikës së Moldavisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin, nënshkruesit ranë dakord se dispozitat e mëposhtëme do të jenë pjesë përbërëse e kësaj Konvente.

Termi “kapitali” do të përfshijë pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme si dhe çdo lloj tjetër pasurie, sipas ligjeve tatimore të Shtetit Kontraktues në të cilin këto pasuri janë vendosur.

Nënshkruesit, në praninë dhe të autorizuar në mënyrën e duhur, kanë nënshkruar këtë Protokoll.

L I G J

Nr.9037, datë 27.3.2003

PËR RATIFIKIMIN E “PROTOKOLLIT TË KATËRT SHITESË TË MARRËVESHJES PËR FORCAT PAQERUAJTËSE SHUMËKOMBËSHE TË EUROPËS JUGLINDORE”

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Protokolli i katërt shtesë i Marrëveshjes për Forcat Paqeruajtëse Shumëkombëshe të Europës Juglindore”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3788, datë 22.4.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

PROTOKOLLI

I KATËRT SHITESË I MARRËVESHJES PËR FORCAT PAQERUAJTËSE SHUMËKOMBËSHE PËR EUROPËN JUGLINDORE

Shtetet Palë të Marrëveshjes për Forcat Paqeruajtëse Shumëkombëshe për Europën Juglindore (MPFSEE), firmosur në Shkup, më 26 shtator 1998, e plotësuar dhe përmirësuar me protokollin e parë shtesë dhe firmosur në Athinë, më 12 janar 1999, e plotësuar me protokollin e dytë shtesë dhe firmosur në Bukuresht, më 30 nëntor 1999 dhe protokollin e tretë shtesë të firmosur në Athinë, më 21 qershor 2000:

duke rikonfirmuar angazhimin e tyre ndaj qëllimeve dhe parimeve të përfshira në Marrëveshjen e MPFSEE-së (Marrëveshja);

me vullnetin për të përmirësuar më tej Marrëveshjen për Forcat Paqeruajtëse Shumëkombëshe të Europës Juglindore, për zgjerimin e iniciativës së MPFSEE-së dhe për të arritur nivele më të larta të ndëroperativitetit, duke përfshirë dispozita shtesë dhe duke rregulluar tekstet ekzistuese, procedurat dhe shkurtesat, me qëllim që ato të jenë në linjë me praktikën dhe terminologjinë e NATO-s,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

1. Neni 1, paragrafi 1/o i Marrëveshjes është përmirësuar për t'u lexuar si më poshtë:

“Vendosje personeli (PE) nënkupton tryezën që rregullon strukturën rutinë organizative të autorizuar, si dhe kërkesat e personelit për stafe bazë të Shtabit të Lartë SEEBRIG”.

2. Në nenin 1, paragrafi 1 i Marrëveshjes, përfshihet një nënparagraf i ri “e”, i cili lexohet si më poshtë:

“e. “Planet e përgjithshme operacionale” nënkupton plane, të cilat zhvillohen për operacione të mundshme, ku disa nga faktorët planifikues (p.sh gama, forcat, destinacioni, rreziqet, fusha e përgjegjësisë etj.) nuk janë plotësisht të identifikuar ose nuk mund të parashikohen. Këto plane zhvillohen në nivelin e detajeve të kërkuara dhe identifikojnë kapacitetet e nevojshme”.

Numri i nënparagrafëve në vazhdim ndryshon përkatësisht.

3. Neni 2, paragrafi 1 i Marrëveshjes është përmirësuar dhe lexohet si më poshtë:

“1. Palët sigurohen se veprimtaritë e Forcës Paqeruajtëse të Europës Juglindore (MPFSEE) janë në përputhje me qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara”.

4. Titulli i nenit 3 të Marrëveshjes është përmirësuar dhe lexohet si më poshtë:

“Vendosje, dislokim dhe përdorim i brigadës së Europës Juglindore”.

5. Neni 3, paragrafi 1 i Marrëveshjes është përmirësuar dhe lexohet si më poshtë:

“1. Palët e përfshira, vendosin një komponent ushtarak të MPFSEE-së në nivel brigade, Brigadën e Europës Juglindore (SEEBRIG). Vendndodhja e Shtabit të Lartë SEEBRIG/stafit bazë do të përcaktohen me konsensus ndërmjet Palëve”.

6. Neni 4, paragrafi 3 i Marrëveshjes është përmirësuar dhe lexohet si më poshtë:

“Takimet ministeriale të mbrojtjes do të rishikojnë subjektet ushtarake dhe marrin vendime/rekomandime sipas rastit, veçanërisht pjesëmarrjen në operacione, udhëzime të gjithanshme për angazhimin e SEEBRIG, ROEs, miratimin e planeve të përgjithshme operative dhe planet operative të paparashikuara. Ministerialet e mbrojtjes marrin vendime mbi dhënien e statusit të vendit vëzhgues”.

7. Në nenin 4 paragrafët 1, 4, 5 dhe 16 të Marrëveshjes fjala “i përgjithshëm” është vendosur pas fjalës “mbrojtje” dhe fjala e përmirësuar është “shtabet e përgjithshme/të mbrojtjes”.

8. Neni 4, paragrafi 6 i Marrëveshjes është përmirësuar dhe lexohet si më poshtë:

“Një komitet drejtues politiko-ushtarak do të ngrihet dhe do të shërbejë si trupë e bashkuar ekzekutive për mbikëqyrjen dhe sigurimin e udhëzimeve politike për dislokimin, angazhimin dhe veprimtari të tjera të SEEBRIG”.

9. Neni 4, paragrafi 12 i Marrëveshjes është përmirësuar dhe do të lexohet si më poshtë:

“PMSC-ja do të përpunojë politika dhe udhëzime për miratime në ministeriale, të nevojshme për mundësimin e një funksionimi efektiv dhe angazhim të SEEBRIG, si dhe veprimtari të tjera të MPFSEE-së në fushat e mëposhtme”.

10. Neni 4, paragrafi 14/a i Marrëveshjes është përmirësuar dhe do të lexohet si më poshtë:

“a. Miraton planet e përgjithshme operacionale dhe planet operacionale të paparashikuara të përgatitura në stafet bazë, sipas direktivave të ministrave të MPFSEE-së”.

11. Në nenin 4, paragrafi 15/a dhe në aneksin E, neni 5, paragrafi 5 i Marrëveshjes fjala “miratim” është zëvendësuar nga fjala “paraqitje”.

12. Neni 7, paragrafi 4 i Marrëveshjes është përmirësuar dhe do të lexohet si më poshtë:

“Stafet bazë, në koordinim të ngushtë dhe në konsultim me shtabet e larta të vendeve respektive do të përpunojnë procedura operative të qëndrueshme, të dhëna bazë dhe opsione për lëvizjen strategjike të nevojshme për zvogëlimin paraprakisht të kohës së planifikimit dhe dislokimit në çdo rast dislokimi. Ai planifikon dhe përgatit drejtimin e trajnimeve dhe stërvitjeve operacionale dhe logjistike, bazuar në vendimet e komitetit drejtues politiko-ushtarak. Ai përpunon planet operative të përgjithshme dhe planet operative të paparashikuara. Merr pjesë në misione për gjetje faktesh, të cilat zhvillohen në përgatitjen për misionet që përfshijnë dislokimin dhe angazhimin e SEEBRIG”.

13. Aneksi A, paragrafi 1 i Marrëveshjes është përmirësuar dhe do të lexohet:

“Detajet e strukturës së SEEBRIG, të përcaktuara me paragrafët 1-4 në nenin 6 të kësaj Marrëveshjeje, janë si më poshtë:”

14. Aneksi C, paragrafi 2/c i Marrëveshjes është përmirësuar dhe do të lexohet si më poshtë:

“Çdo shtesë ose zvogëlim në ndarjen e miratuar të posteve ose çdo ndryshim në ndarjen e miratuar të posteve duhet bërë me miratimin e ministrave të mbrojtjes së palëve me konsensus pas propozimit të PMSC-së”.

15. Në aneksin E, neni 4, paragrafi 2 i Marrëveshjes pas “15 shtator PMSC” fjala “takim” është hequr.

Neni 2

1. Termi “Brigadë” është zëvendësuar me shkurtesën “SEEBRIG” në:

- Neni 1, paragrafi 1/s i Marrëveshjes
- Neni 3, paragrafët 2,6,7 dhe 8 të Marrëveshjes
- Neni 6, paragrafi 3 i Marrëveshjes
- Neni 7, paragrafët 2, 5 dhe 7 të Marrëveshjes
- Neni 11, paragrafi 2 i Marrëveshjes
- Neni 17, paragrafi 2 i Marrëveshjes
- Aneksi A, paragrafi 4 i Marrëveshjes
- Aneksi C, paragrafi 5/a (5) i Marrëveshjes
- Aneksi E, neni 3, paragrafët 1 dhe 1/c të Marrëveshjes
- Nenet 1, 2, 3 dhe 4 të protokollit shtesë të Marrëveshjes

2. Termat “Forcë” dhe “Forca” janë zëvendësuar me shkurtesën “SEEBRIG” në:

- Neni 3, paragrafi 3 dhe 5 i Marrëveshjes
- Neni 4, paragrafët 2 i Marrëveshjes
- Neni 6, paragrafët 1, 2, 4 dhe 5 të Marrëveshjes
- Neni 7, paragrafët 7 dhe 8 të Marrëveshjes
- Neni 8, paragrafi 1 i Marrëveshjes
- Neni 10, paragrafi 1 i Marrëveshjes
- Neni 11, paragrafi 1 i Marrëveshjes
- Neni 12, paragrafi 1 i Marrëveshjes
- Neni 15, paragrafi 2 i Marrëveshjes
- Aneksi A dhe C të Marrëveshjes, titujt.
- Aneksi A, paragrafi 10 i Marrëveshjes
- Aneksi E, neni 3, paragrafi 1/c(3)/(d) i Marrëveshjes

3. Termi “Forcë HQ” zëvendësohet me termin “HQ SEEBRIG” në:

- Neni 4, paragrafët 12/f, 14/e, 15 f të Marrëveshjes
- Neni 7, paragrafët 1 dhe 3 të Marrëveshjes
- Neni 10, paragrafi 4 i Marrëveshjes
- Aneksi D, neni 2, paragrafi 5 i Marrëveshjes

4. Shkurtesa “MPFSEE” zëvendësohet nga shkurtesa “SEEBRIG” në:

- Neni 9, paragrafi 3 i Marrëveshjes
- Aneksi D, neni 5, paragrafi 10 i Marrëveshjes
- Aneksi E, neni 3, paragrafët 1/c (1); 1/c (1) (d); 1/c (1) (e); 1/c (1) (g); 1/c (3) (d); 1/c (3) (h)

të Marrëveshjes.

- Aneksi E, neni 4, paragrafët 1/a dhe 3/a të Marrëveshjes
- Aneksi -E, neni 5, paragrafi 1 i Marrëveshjes
- Aneksi E, neni 9, paragrafi 1 i Marrëveshjes

5. Termat “MPFSEE HQ” dhe “HQ e MPFSEE” zëvendësohen me termin “HQ SEEBRIG”

në:

- Aneksi B, paragrafët 3 dhe 4 të marrëveshjes
- Aneksi D, neni 1, paragrafët 2 dhe 4 të Marrëveshjes
- Aneksi -D, neni 2, paragrafët 2 dhe 4 të Marrëveshjes
- Aneksi D, neni 3, paragrafët 1 dhe 2 të Marrëveshjes
- Aneksi D, neni 4, titujt, paragrafët 1 dhe 2 të Marrëveshjes
- Aneksi D, neni 5, 9, paragrafët 1, 2, 5, 6, 8, 10, 11, 12, 13, a dhe c; 14 dhe 15 të

Marrëveshjes

- Aneksi D, neni 6, paragrafët 1 dhe 2 të Marrëveshjes
- Aneksi D, shtesë 1, titujt e të Marrëveshjes
- Aneksi E, neni 3, paragrafët 1/c (1) (b) dhe 1/c (c) të Marrëveshjes
- Aneksi E, neni 4, paragrafi 1/a i Marrëveshjes
- 6. Shkurtesa MPFSEE zëvendësohet me shkurtesën “SEEBRIG” në:
 - Aneksi C, paragrafët 5/a (7) (a) (i); 5/a (7) (a) (V) dhe 5/a (7) (a) (VI) të Marrëveshjes.
- 7. Termat “Shtab i përhershëm (PHQ) MPFSEE dhe “PHQ MPFSEE” zëvendësohen nga termi “HQ SEEBRIG” në:
 - Aneksi E, neni 1, paragrafi 2 i Marrëveshjes
 - Aneksi E, neni 3, paragrafët 1; 1/c (1) (a); 1/c (1) (d); 1/d (1) dhe 1/h (4) të Marrëveshjes
 - Aneksi E neni 4, paragrafi 1/b i Marrëveshjes
 - Aneksi E, neni 8, paragrafi 1 i Marrëveshjes
- 8. Termi “Komandant brigade” dhe shkurtesat “COM/MPFSEE” dhe “COMMPFSEE” zëvendësohen nga shkurtesa “COMSEEBRIG” në:
 - Neni 4, paragrafi 12/a i Marrëveshjes
 - Aneksi B, paragrafët 2,5 dhe 6 të Marrëveshjes
 - Aneksi C, paragrafët 5/a (5) dhe 5/a(6) të Marrëveshjes
 - Aneksi D neni 5, paragrafi 4 i Marrëveshjes
 - Aneksi E, neni 2, paragrafi 1 i Marrëveshjes
 - Aneksi E, neni 3, paragrafët 1/c (1) (g) dhe 1/h (1) të Marrëveshjes
 - Aneksi E, neni 4, paragrafët 2/a, pas 31 korrikut dhe 2/b të Marrëveshjes
 - Aneksi E, neni 5, paragrafi 4, 5 të Marrëveshjes
 - Aneksi E, neni 7, paragrafi 1 i Marrëveshjes
 - Aneksi E, neni 8, paragrafi 2 i Marrëveshjes
 - Neni 2 i protokollit shtesë të Marrëveshjes.
- 9. Termi “Organizim i veprimit” (ORACT) zëvendësohet me termin “radha e luftimit” (ORBAT) në:
 - Neni 1, paragrafi 1/i i Marrëveshjes
 - Neni 6, paragrafi 5 i Marrëveshjes
 - Aneksi A, paragrafi 4, 5 dhe 6 i Marrëveshjes
- 10. Termat “Procedura standarde veprimi” zëvendësohet me termin “Procedura të qëndrueshme veprimi” (SOP) në aneksi C, paragrafi 4/b/(2)/(a) të Marrëveshjes.
- 11. Termi “Komandë operationale” zëvendësohet nga termi “Kontroll operacional” në aneksi C, paragrafi 5/a (7)/b/(i) i Marrëveshjes.

Neni 3

1. Titujt e shtojcës aneksi A të Marrëveshjes janë përmirësuar dhe do të lexohen si më poshtë:
 - “Shtojcat
 - Shtojca –1: Struktura e përgjithshme SEEBRIG
 - Shtojca –2: Kontributi me trupa nga palët
 - Shtojca –3: Organizimi i SEEBRIG”.
2. Versioni i përmirësuar i shtojcës 2 të aneksit A të Marrëveshjes është bashkëlidhur.
3. Versioni i përmirësuar i shtojcës 3 të aneksit A të Marrëveshjes është bashkëlidhur.
4. Versioni i përmirësuar i shtojcës së aneksit B të Marrëveshjes është bashkëlidhur.
5. Versioni i përmirësuar i shtojcës 1 të aneksit C të Marrëveshjes është bashkëlidhur.
6. Versioni i përmirësuar i shtojcës 2 të aneksit C të Marrëveshjes është bashkëlidhur.
7. Versioni i përmirësuar i shtojcës 3 të aneksit C të Marrëveshjes është bashkëlidhur.
8. Versioni i përmirësuar i shtojcës 4 të aneksit C të Marrëveshjes është bashkëlidhur.
9. Versioni i përmirësuar i vendndodhjes së shtabit të SEEBRIG-së dhe tabela e domosdoshme e vendeve me rotacion në protokollin shtesë së Marrëveshjes është bashkëlidhur.
10. Versioni i përmirësuar i aneksit A të protokollit të dytë shtesë të Marrëveshjes është bashkëlidhur.

Neni 4

1. Në aneksin C, paragrafi 2/e i Marrëveshjes, fjala “CE” është vendosur pas shkurtesës “PE”.
 2. Aneksi C, paragrafi 4/b/2) i Marrëveshjes është përmirësuar dhe do të lexohet si më poshtë: “(e) përpunon “Plane të përgjithshëm operacionale (GOP) dhe plane operacionale të paparashikuara (COP)”.
 3. Në aneksin C, paragrafi 5/c (1) i Marrëveshjes, fjala “të paktën” është vendosur mbas fjalës “vite”.
 4. Në aneksin C, paragrafi 5/d i Marrëveshjes, paragrafët e mëposhtëm vendosen mbas nënparagrafit (1):
 - (2) DCOS OPS përgjigjet për zbulimin dhe kundërzbulimin, për operacionet e bashkëpunimit civilo-ushtarak dhe xhenion.
 - (3) DCOS SUP përgjigjet për personel, logjistikë, sistem informacioni, komunikimi, dhe financë.
- Numërimi i nënparagrafëve do të ndryshojë përkatësisht.
5. Në aneksin E, neni 3, paragrafi 1/c (1) (g) i Marrëveshjes është hequr fjala “do të përpunohet”.
 6. Aneksi E, neni 4, paragrafi 2/a i Marrëveshjes është përmirësuar dhe do të lexohet si më poshtë:
“PMSC paraqet buxhetin dhe ja kalon atë ministrave”.

Neni 5

1. Ky protokoll është pjesë integruese e Marrëveshjes për Forcat Paqeruajtëse Shumëkombëshe të Europës Juglindore, e firmosur në shkurt, më 26 shtator 1998, e shtuar dhe e përmirësuar me protokollin shtesë të firmosur në Athinë, më 12 janar 1999, me protokollin e dytë shtesë të firmosur në Bukuresht, më 30 nëntor 1999 dhe protokollin e tretë shtesë të firmosur në Athinë, më 21 qershor 2000.
2. Ky protokoll i nënshtrohet ratifikimit ose miratimit. Dhjetë (10) ditë mbasi katër palët kanë njoftuar depozitimin për plotësime të procedurave të tyre të brendshme, ky protokoll hyn në fuqi ndërmjet tyre. Për palët e tjera ai hyn në fuqi 10 ditë mbasi ata njoftojnë depozitimin për plotësimin e procedurave të tyre të brendshme. Dispozitat e nenit 3, paragrafët 2, 3, 6, 8 dhe 12 hyjnë në fuqi pasi ka hyrë në fuqi protokollin e dytë shtesë.

Në emër të shteteve palë të Marrëveshjes:

_____, Ministri i Mbrojtjes (shteti 1)
_____, Ministri i Mbrojtjes (shteti 2)
_____, Ministri i Mbrojtjes Kombëtare (shteti 3)
_____, Ministri i Mbrojtjes (shteti 4)
_____, Ministri i Mbrojtjes (shteti 5)
_____, Ministri i Mbrojtjes Kombëtare (shteti 6)
_____, Ministri i Mbrojtjes Kombëtare (shteti 7)

L I G J

Nr.9038, datë 27.3.2003

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË KROACISË PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE ME QËNDRIM TË PALIGJSHËM”

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Kroacisë për ripranimin e personave me qëndrim të paligjshëm”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3789, datë 22.4.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

MARRËVESHJE

**NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS
TË KROACISË MBI PRANIMIN E PERSONAVE, QËNDRIMI I TË CILËVE ËSHTË I
PALIGJSHËM**

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kroacisë (këtu dhe në vazhdim Palët Kontraktuese):

me dëshirën të zhvillojnë marrëdhëniet miqësore, si dhe për të siguruar një zbatim të efektshëm të dispozitave të legjislacionit të tyre kombëtar për lëvizjen e personave;
duke respektuar ndërkohë të drejtat dhe garancitë e parashikuara në to;
me angazhimin e tyre për parandalimin e migracionit të paligjshëm;
në frymën e bashkëpunimit, si edhe mbi baza të reciprocitetit,
kanë rënë dakord sa më poshtë:

KAPITULLI I

RIPRANIMI I SHTETASVE TË PALËVE KONTRAKTUESE

Neni 1

1. Secila Palë Kontraktuese, me anë të një kërkesë me shkrim të Palës tjetër Kontraktuese, do të ripranojë, pa formalitete, në territorin e saj, ndonjë person, i cili nuk i përmbushte ose nuk i përmbush më kushtet në fuqi për të hyrë ose qëndruar në territorin e Palës Kontraktuese kërkuese, kur sigurohet se është vërtetuar ose vlefshmërisht mund të prezumohet se ai/ajo mban shtetësinë e Palës Kontraktuese të kërkuar. E njëjta do të zbatohet për personat të cilët, pasi kanë hyrë në territorin e Palës Kontraktuese kërkuese, kanë humbur shtetësinë e Palës Kontraktuese të kërkuar ose iu është hequr shtetësia e kësaj Pale me anë të kërkesës së tyre pa pasur një procedurë të hapur të natyralizimit me Palën Kontraktuese kërkuese.

2. Në rast se kontrollet pasuese provojnë se personi i ripranuar nuk ka qenë një shtetas i Palës Kontraktuese të kërkuar dhe nëse klauzolat e nenit 4 dhe nenit 5 të kësaj Marrëveshjeje nuk janë të zbatueshme për personin në fjalë, Pala tjetër Kontraktuese do ta ripranojë përsëri atë person pa vonesë.

Neni 2

1. Shtetësia e personit që do të ripranohet do të vërtetohet mbi bazën e dokumenteve të mëposhtme:

a) Për Republikën e Shqipërisë:

- dokumenteve të shtetësisë, për të cilat nuk ka dyshim se i përkasin një personi;

- kartë personale identifikimi;
 - dokument udhëtimi të lëshuar nga autoriteti kompetent;
 - librezë të shërbimit ushtarak.
- b) Për Republikën e Kroacisë:
- certifikatë shtetësie me një dokument tjetër, me anë të të cilit identiteti mund të vërtetohet;
 - kartë personale identifikimi;
 - dokument udhëtimi të lëshuar nga autoriteti kompetent;
 - librezë të shërbimit ushtarak.
2. Shtetësia prezumohet mbi bazë të:
- dokumenteve të përcaktuara në paragrafin 1, vlefshmëria e të cilave ka skaduar;
 - dokumenteve të lëshuara nga autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese të kërkuar, të cilat të përmbajnë identitetin e personit në fjalë (p.sh.: dëshminë e aftësisë për drejtim automjeti, etj.);
 - dokumenteve të lëshuara nëpërmjet misionit kompetent diplomatik ose zyrës konsullore të Palëve Kontraktuese;
 - një deklaratë të personit në fjalë të mbajtur në regjistrat e autoriteteve administrative ose gjyqësore të Palës Kontraktuese kërkuese;
 - deklaratave të regjistruara të dëshmitarëve të besueshëm.

Neni 3

1. Në rast se shtetësia është prezumuar, por dokumentet e listuara në nenin 2, paragrafi 2 të kësaj Marrëveshjeje nuk ekzistojnë ose janë të diskutueshme, shtetësia mund të vërtetohet, në bazë të kërkesës së Palës Kontraktuese kërkuese, me asistencë të misionëve diplomatike kompetente ose zyrave konsullore të Palës Kontraktuese të kërkuar, të cilat do të intervistojnë personin në fjalë. Personi do të intervistohet pa vonesë, por jo më vonë se tri ditë pune nga marrja e kërkesës. Intervista do të organizohet nga Pala Kontraktuese kërkuese në marrëveshje me misionet diplomatike kompetente ose me zyrat konsullore të Palëve Kontraktuese.

2. Në rast se shtetësia është prezumuar mbi bazë të dokumenteve të listuara në nenin 2 paragrafi 2 të kësaj Marrëveshjeje ose konfirmohet në përputhje me paragrafin 1 të kësaj Marrëveshjeje, organet konsullore të Palës Kontraktuese të kërkuar do të lëshojnë, pa vonesë, dokumentet e nevojshme për kthimin e personit në fjalë në vendin e tij të shtetësisë.

KAPITULLI II

RIPRANIMI I SHTETASVE TË VENDIT TË TRETË OSE TË PERSONAVE PA SHTETËSI

Neni 4

1. Secila Palë Kontraktuese, në bazë të një kërkesë me shkrim nga Pala tjetër Kontraktuese, ripranon, pa formalitete, një shtetas të vendit të tretë ose një person pa shtetësi, i cili nuk i përmbushte ose nuk i përmbush më kushtet në fuqi për hyrje, të cilat janë të zbatueshme në territorin e Palës Kontraktuese kërkuese, në rast se vërtetohet se personi ka hyrë në territorin e saj pas qëndrimit të tij/saj ose pas kalimit transit nëpërmjet territorit të Palës Kontraktuese të kërkuar.

2. Secila Palë Kontraktuese, bazuar në kërkesën me shkrim nga Pala tjetër Kontraktuese, ripranon pa formalitete, një shtetas të vendit të tretë ose një person pa shtetësi, i cili nuk i plotësonte ose nuk i plotëson më kushtet në fuqi për hyrje ose qëndrim, të cilat janë të zbatueshme në territorin e Palës Kontraktuese kërkuese, në rast se ky shtetas mban një vizë të vlefshme, përveç vizës transit, ose lejeqëndrimi të çdo lloji, të lëshuara nga Pala Kontraktuese e kërkuar. Në rastet në të cilat të dyja Palët Kontraktuese kanë lëshuar një vizë ose një lejeqëndrim, përgjegjësia do t'i mbetet Palës Kontraktuese, viza ose leja e qëndrimit e të cilës skadojnë më vonë.

Neni 5

Detyrimi i ripranimit i përcaktuar në nenin 4 të kësaj Marrëveshjeje nuk do të zbatohet për:

- a) shtetasit e një vendi të tretë, i cili ka një kufi të përbashkët me Palën Kontraktuese kërkuuese;
- b) shtetasit e vendit të tretë, të cilët, me largimin nga territori i Palës Kontraktuese të kërkuar ose me hyrjen në territorin e Palës Kontraktuese kërkuuese, kanë marrë nga kjo Palë Kontraktuese një vizë ose një lejeqëndrim;
- c) shtetasit e vendit të tretë, të cilët kanë qëndruar në territorin e Palës Kontraktuese kërkuuese me shumë se gjashtë muaj;
- d) shtetasit e vendit të tretë, të cilëve u është dhënë statusi i refugjatit nga Pala Kontraktuese kërkuuese në përputhje me Konventën që ka lidhje me statusin ligjor të refugjatit, firmosur në Gjenevë, më 28 korrik 1951, amenduar nga protokollin, i cili ka të bëjë me statusin e refugjatit, bërë në Nju Jork, më 31 janar 1967 ose me statusin e personit pa shtetësi në përputhje me Konventën, e cila ka të bëjë me statusin e personave pa shtetësi, bërë në Nju Jork, më 28 shtator 1954;
- e) shtetas të vendit të tretë, për të cilin është provuar se, pas largimit nga territori i Palës Kontraktuese të kërkuar, ai/ajo ka hyrë në territorin e Palës Kontraktuese kërkuuese, nga territori i një vendi tjetër të tretë, tek i cili Pala Kontraktuese kërkuuese mund ta kthejë këtë shtetas mbi bazë të Marrëveshjes së ripranimit.

Neni 6

Pala Kontraktuese kërkuuese do t'i ripranojë personat, për të cilët Pala Kontraktuese e kërkuar më pas ka vërtetuar se, në kohën e nisjes nga territori i Palës Kontraktuese kërkuuese, nuk i përmbushte kushtet e përcaktuara në nenet 4 dhe 5 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7

Kërkesa për ripranimin e shtetasit të vendit të tretë ose të personit pa shtetësi duhet të përmbajë të dhënat personale të mëposhtme të personit (emrin, mbiemrin, emra të mesëm, nofka ose pseudonime, ndonjë emër të mëparshëm, datën dhe vendin e lindjes, seksin), shtetësinë e tij aktuale ose ndonjë shtetësi të mëparshme, të dhëna mbi dokumentet e mbajtura nga personi (tipin, numrin, datën e lëshimit, autoritetin lëshues vendin e lëshimit, datën e skadencës etj.) të dhëna mbi qëndrimin e tij në territorin e Palës Kontraktuese të kërkuar, si edhe të dhëna mbi rrethanat e hyrjes së tij/saj në territorin e Palës Kontraktuese kërkuuese.

KAPITULLI III AFATET KOHORE

Neni 8

1. Pala Kontraktuese e kërkuar do t'i përgjigjet kërkesave që i adresohen asaj, pa asnjë vonesë, dhe në ndonjë rast jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë me marrjen e kërkesës.

2. Pala Kontraktuese e kërkuar do të pranojë personat, ripranimi i të cilave është aprovuar, pa asnjë vonesë, dhe në ndonjë rast jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë. Me kërkesën e Palës Kontraktuese kërkuuese, ky afat kohor mund të shtyhet në varësi të kohës së nevojshme për zgjidhjen e pengësive ligjore ose praktike.

Neni 9

Kërkesa për ripranimin e personit duhet të dorëzohet maksimalisht brenda një muaji pasi Pala Kontraktuese ka vërtetuar hyrjen ose qëndrimin e paligjshëm të shtetasit në fjalë të vendit të tretë në territorin e saj, por jo më vonë se afati i përcaktuar në nenin 5 (c).

KAPITULLI IV TRANSITIM

Neni 10

1. Secila Palë Kontraktuese, me kërkesën me shkrim të Palës tjetër Kontraktuese, do të lejojë transitimin përmes territorit të saj, për shtetasit e vendit të tretë, të cilët janë larguar nga territori i Palës Kontraktuese, e cila kërkon transitin.

2. Pavarësisht nga ndonjë autorizim i lëshuar, Pala Kontraktuese kërkuuese do të mbajë përgjegjësi të plotë për transitimin e një të huaji për në vendin e tij/saj përfundimtar të destinacionit dhe do të ripranonjë të huajin në rast se hyrja e tij/saj në një shtet të tretë nuk është lejuar ose në rast se për disa arsye udhëtimi i tij/saj i mëtejshëm provohet të jetë i pamundur.

3. Pala Kontraktuese që kërkon transitimin do të garantojë Palën tjetër Kontraktuese se shtetasi i vendit të tretë ose personi pa shtetësi, të cilit i është dhënë e drejta për transitim, disponon të gjitha dokumentet e nevojshme.

4. Pala Kontraktuese që kërkon transitimin duhet të informojë Palën Kontraktuese të kërkuar nëse është e nevojshme për të siguruar eskortim për personin që do të largohet. Pala Kontraktuese e kërkuar:

- mund të marrë vendim nëse duhet të sigurojë nga ana e saj eskortimin;
- mund të sigurojë eskortimin në bashkëpunim me Palën Kontraktuese kërkuuese transituere.

5. Në rast se transitimi me eskortë kryhet duke përdorur shërbimin e linjës ajrore të Palës Kontraktuese kërkuuese transituere, e njëjta Palë Kontraktuese do të sigurojë eskortimin, mbajtjen në zonën transit të një aeroporti ndërkombëtar të Palës Kontraktuese të kërkuar.

6. Në rast se transitimi me eskortë kryhet duke përdorur një linjë ajrore të Palës Kontraktuese të kërkuar, e njëjta Palë Kontraktuese do të sigurojë eskortimin.

Neni 11

Një kërkesë për transit duhet të përmbajë të dhëna personale dhe të dhëna mbi shtetësinë e personit që do të largohet, datën e transitit, orën dhe vendin e hyrjes në territorin e Palës Kontraktuese të kërkuar, orën dhe vendin e nisjes nga territori i Palës Kontraktuese të kërkuar për në vendin e destinacionit, të dhëna të tjera, të cilat kanë lidhje me transitimin, garanci që personi në fjalë do të pranohet në vendin e destinacionit, si edhe të dhëna mbi personelin e eskortimit.

Neni 12

Transiti për qëllime të largimit mund të mos pranohet në rast se një shtetas i një vendi të tretë ose një person pa shtetësi:

- i nënshtrohet rrezikut të përndjekjes në vendin e destinacionit final dhe/ose në ndonjë vend tjetër të transitit të mëvonshëm për shkak të racës së tij/saj, fesë, shtetësisë, bindjeve politike ose lidhjes me një grup të veçantë social;
- paraqet një kërcënim për sigurinë kombëtare, rendin publik ose shëndetin publik të Palës Kontraktuese të kërkuar.

KAPITULLI V MBROJTJA E TË DHËNAVE

Neni 13

Të dhënat personale do të përdoren vetëm për qëllime të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje dhe mbrojtja e tyre do të sigurohet në përputhje me legjislacionin kombëtar të Palëve Kontraktuese. Në veçanti, secila Palë Kontraktuese merr përsipër:

a) të përdorë ndonjë informacion të marrë në bazë të kësaj Marrëveshjeje vetëm për qëllimin për të cilin është kërkuar;

b) të mbajë të fshehtë çdo informacion të tillë të paraqitur tek Pala Kontraktuese e kërkuar dhe të mos e zbulojë atë për një palë të tretë, me përjashtim të rasteve kur ky zbulim është i autorizuar nga Pala Kontraktuese kërkuuese;

c) të mbrojë një informacion të tillë ndaj humbjeve aksidentale, mundësisë për ta zbuluar të paautorizuar, ndryshimit ose zbulimit;

d) të shkatërrojë një informacion të tillë në përputhje me kushtet e paraqitura nga Pala

Kontraktuese kërkuese dhe, në rast se nuk ka kushte të tilla të paraqitura, sapo informacioni nuk kërkohet më për qëllimin për të cilin informacioni është dërguar.

KAPITULLI V SHPENZIMET

Neni 14

1. Shpenzimet e kthimit të personave të ripranuar, në përputhje me nenet 1 dhe 4 të kësaj Marrëveshjeje, do të mbulohen nga Pala Kontraktuese kërkuese deri tek kufiri i Palës Kontraktuese të kërkuar.

2. Shpenzimet e transportimit dhe të eskortimit deri tek kufiri i vendit të destinacionit dhe shpenzimet e kthimit të mundshëm, në përputhje me nenin 10 të kësaj Marrëveshjeje, do të mbulohen nga Pala Kontraktuese kërkuese.

KAPITULLI VI KLAUZOLAT E PËRGJITHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 15

Pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Ministrinë e Rendit Publik dhe të Brendshme të Palëve Kontraktuese do të konkludojnë një protokoll për zbatimin e saj.

Neni 16

Klauzolat e kësaj Marrëveshjeje nuk do të prekin ndonjë detyrim të Palëve Kontraktuese, të cilat rrjedhin nga marrëveshjet e tjera ndërkombëtare.

Neni 17

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi tridhjetë (30) ditë nga data e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike dhe kur të jenë përmbushur të gjitha parakushtet e kërkuara nga legjislacionet e brendshme të Palëve Kontraktuese për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Secila Palë Kontraktuese mund të pezullojë përkohësisht këtë Marrëveshje, plotësisht ose pjesërisht, përveç nenit 1 të kësaj Marrëveshjeje, për arsye të mbrojtjes së sigurisë kombëtare, të rendit publik ose të shëndetit publik, me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Palës tjetër Kontraktuese nëpërmjet kanaleve diplomatike. Pezullimi do të bëhet i efektshëm ditën e marrjes së një njoftimi të tillë nga Pala tjetër Kontraktuese.

3. Kjo Marrëveshje është përfunduar për një periudhë kohore të papërcaktuar. Secila Palë Kontraktuese mund ta shpallë të pavlefshme këtë Marrëveshje në çdo kohë me një njoftim me shkrim drejtuar Palës tjetër Kontraktuese nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në këtë rast, kjo Marrëveshje do të pushojë së qeni në fuqi tridhjetë (30) ditë nga data e marrjes së njoftimit nga Pala tjetër Kontraktuese.

Bërë në Zagreb, më 28 janar 2003, në dy kopje origjinale, secila në gjuhët shqipe, kroate dhe angleze, të gjitha tekstet janë autentikisht të barasvlefshme. Në rast të ndonjë keqinterpretimi në përkthim, do të merret parasysh teksti në gjuhën angleze.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

U dorëzua për shtyp më 5.5.2003
Doli nga shtypi më 7.5.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë